

PUSHTETI I PANDASHËM

Analizë e pavarësisë
së pushtetit gjyqësor në Kosovë



Ky botim është realizuar me përkrahjen e Fondacionit të Vëllezërve Rockefeller (RBF).
Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e KIPRED-it.

Përgatitur nga: Adem Gashi e Betim Musliu
Redaktuar nga: Krenar Gashi

E drejta autoriale © 2011 e KIPRED-it. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit. Ju lutem kontaktoni info@kipred.net apo +381 38 227 778.

Botuar nga



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave
Rr. Rexhep Mala, nr. 5A
10 000 Prishtinë, Kosovë
Telefoni dhe faksi: +381 38 227 778
kipred.net

PËRMBAJTJA

1. Hyrje	5
2. Metodologjia.....	7
3. Historik i shkurtër i sistemit gjyqësor në Kosovë.....	8
4. Drejt një gjyqësori të pavarur	10
5. Struktura institucionale dhe marrja e vendimeve	13
6. Bërja e politikave dhe ligjeve	17
7. Përfaqësimi joadekuat.....	21
8. Përpilimi dhe menaxhimi i buxhetit	23
9. Personeli dhe administrata.....	28
10. Ndërhyrjet politike në proceset gjyqësore	33
10.1. Nënshtrimi i gjyqësorit	33
10.2. Politika e ndërhyrjeve	34
10.3. Privilegjet politike	35
11. Përfundimet	37
12. Rekomandimet.....	40
13. Bibliografia.....	42

SHKURTESAT

EULEX	Misioni i BE-së për Sundim të Ligjit në Kosovë
ICO	Zyra Civile Ndërkombëtare
KIPRED	Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KGJPK	Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës
KMDLNJ	Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut
KPGJP	Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
MAP	Ministria e Administratës Publike
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
OAK	Oda e Avokatëve të Kosovës
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
PGJZS	Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
SKGJK	Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
ZPD	Zyra e Prokurorit Disiplinor

1. HYRJJE

Republika e Kosovës ka konsoliduar institucione shtetërore të cilat veprojnë mbi bazën e ndarjes së pushteteve. Një gjë e tillë është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës ndërsa ligjet bazike për sistemin gjyqësor dhe prokurorial të aprovuara në vitin 2010 kanë shtyrë përpara këto dispozita të Kushtetutës.¹

Për vite të tëra, sistemi gjyqësor i Kosovës është kritikuar për mungesë të pavarësisë dhe për korrupsion.² Ndërhyrjet në punën e gjyqësorit rrjedhin pikë së pari si pasojë e një mungese të përvojës demokratike. Gjatë epokës së komunizmit ndarja e pushteteve nuk ka ekzistuar, sidomos jo në Kosovë ku është ushtruar një represion shtetëror. Në një formë tjetër, praktika e njëjtë ka vazhduar edhe në kohën e administrimit ndërkombëtar të Kosovës nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Shefi i këtij misioni, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), ka qenë në të njëjtën kohë shef i legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit. Gjatë kohës së UNMIK-ut, ndërhyrjet nga njëra degë e pushtetit në tjetrën kanë qenë përditshme.³

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, me 17 shkurt 2008, institucionet kanë ndërmarrë një sërë hapash për të përmirësuar këtë praktikë. Si hap i rëndësishëm në këtë aspekt konsiderohet reformimi i sistemit drejtësisë.⁴ Megjithatë, këto reforma nuk kanë mundur të zbatohen asnjëherë pasi ishte zvarritur për vite të tëra miratimi i katër ligjeve themelore të sistemit të drejtësisë. Përfundimisht, miratimi i tyre në pjesën e dytë të vitit 2010 shënon rregullimin e statusit të gjykatësve dhe prokurorëve dhe njëherësh transformimin e tërësishëm të gjykatave dhe prokurorive. Derisa statusi i bartësve të funksioneve gjyqësore është rregulluar pasi kanë hyrë në fuqi pjesërisht dispozitat e ligjeve që sigurojnë paga dinjitoze, ekuivalente me ato të ekzekutivit, por pjesa tjetër e dispozitave do të zbatohet nga viti 2013. Njëkohësisht është krijuar Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) që ka marrë përsipër përgjegjësitë për menaxhimin e prokurorive duke e mënjanuar varësinë e madhe të prokurorive nga ana e Ministrisë së Drejtësisë (MD) në të kaluarën. Me këto ligje kushtet elementare për sundim të ligjit janë plotësuar ku, mes tjerash, përveq rregullimit të statusit të pagave është siguruar mandati i përhershëm i gjykatësve dhe prokurorëve.

Çështje shumë e rëndësishme në sigurimin e pavarësisë së tyre është përcaktimi i mandatit të përhershëm të emërimit pas fazës fillestare prej 3 vjetësh.⁵ Përkundër këtyre nismave të mira

¹ Ligji për Gjykatat, ligji numër 03/L-199; Ligji për Prokurorin e Shtetit, ligji numër 03/L-225; Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, ligji numër 03/L-223; dhe Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, ligji numër 03/L-224.

² Në vitin 2004, Kosova është vlerësuar me notën 6 ndërsa në vitin 2011 me notën 5.75 sa i përket demokratizimit të Kornizës dhe Pavarësisë Gjyqësore (1 është vlera më e lartë, ndërsa 7 vlera më e dobët). Në vitin 2011, për këtë kategori mesatarja për vendet e Ballkanit ka qenë 4.43. Kombet në Tranzicion. Freedom House. 2011.

³ Intervistë e KIPRED-it me një ish gjyqtar në Departamentin e Drejtësisë së UNMIK-ut, mars 2011.

⁴ Nevojat dhe diskutimet për reformimin e sistemit të drejtësisë kishin filluar qysh në vitin 2003 kur dhe janë zhvilluar vlerësimet dhe propozimet e para gjithëpërfshirëse për këtë sistem. Ligji për Gjykatat, ligji numër 03/L-199, si dhe Ligji për Prokurorin e Shtetit, ligji numër 03/L-225, janë dy nga ligjet të cilat kanë siguruar nivelizimin e pagave në mes të gjyqtarëve dhe prokurorëve me pozitave relevante në ekzekutiv si dhe është mundur emërimi i përhershëm. Rekomandimet për ndërmarrjen e këtyre masave sa i përket sistemit gjyqësor ishin dhënë në vitin 2003 në dokumentin “*Sistemi Gjyqësor i Kosovës, Vlerësimi dhe Opsionet e Propozuara.*” UNMIK dhe Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës. 2003-2004.

⁵ Neni 105 [mandati dhe riemërimi], Kapitulli VII – Sistemi i Drejtësisë. Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

të reformimit, sistemi i drejtësisë vazhdon të ballafaqohet me sfida të shumta që zakonisht i takojnë natyrës së lidhshmërisë me pushtetin ekzekutiv.

Në këtë studim, Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED) është përqendruar në hulumtimin e politikave e ligjeve me qëllim që të identifikojë hapësirat ligjore dhe praktikave të dëmshme që ndikojnë në pavarësinë e gjyqësorit. Studimi është përqendruar në pavarësinë ligjore dhe atë praktike, duke analizuar çështjet e buxhetit për organet e pushtetit gjyqësor, bërjen e politikave publike dhe nismat legjislative, administratën e prokurorive dhe gjykatave, funksionimin e organeve udhëheqëse të këtij pushteti dhe ndërhyrjet e ekzekutivit në gjyqësor. Studimi po ashtu ka analizuar tendencën e sistemit të drejtësisë për të rënë pre e ndikimeve nga ekzekutivi, si dhe rastet ku prokurorët dhe gjykatësit refuzojnë të trajtojnë lëndë të cilat kanë të bëjnë me personat që janë pjesë e pushtetit ekzekutiv.

2. METODOLOGJIA

KIPRED ka përdorur një metodologji të përzier të hulumtimit për përpilimin e këtij punimi. Kjo për shkak se sistemi gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë është i ri dhe se të dhënat janë të mangëta. Arsye tjetër është se pavarësia e pushtetit gjyqësor përceptohet në mënyra të ndryshme dhe deri më tani nuk është arritur deri te një marrëveshje që do të ishte model universal në të gjitha vendet.

Formulimi i problemit është bërë me grumbullimin e shqetësimeve fillestare që janë ngritur me fillimin e reformës të sistemit të drejtësisë në vend. Në hulumtim e sipër, kemi konsoliduar problemin e ngritur nëpërmjet rishikimit të literaturës dhe legjislacionit në fushën e sistemit të drejtësisë. Në fund, kemi përdorur metodën kualitative të intervistave të thella me zyrtarë institucionesh, bartës të funksioneve kyçe në të tri pushtetet si dhe ekspertë të fushës së drejtësisë.

Së pari, është bërë analiza e kornizës ligjore, përfshirë këtu ligjet në fuqi dhe ligjet e mëhershme. Në këtë kontekst janë përfshirë edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji për Gjykatat, Ligji për Prokurorin e Shtetit, Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Ligji për Gjykatën Kushtetuese, Ligji për Pagat e Nëpunësve Civil, Ligji për Shërbimin Civil, si dhe rregullore, urdhëresa administrative dhe akte të ndryshme normative të institucioneve që obligohen t'i zbatojnë ato.

Pas rishikimit të këtyre ligjeve që ndërlidhen me punën e pushtetit gjyqësor, KIPRED ka analizuar pavarësinë e gjyqësorit nëpër vendet tjera si dhe rekomandimet dhe studimet e bëra nga Këshilli i Evropës dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara, si dy institucione të cilat kanë përpiluar standarde për këtë fushë.

Në përfundim të analizës së dokumenteve të ndryshme, KIPRED ka hartuar një listë të çështjeve të cilat janë evidentuar si brenga më urgjente sa i përket pavarësisë së pushtetit gjyqësor në Kosovë. Pas përfundimit të kësaj analize preliminare, janë zhvilluar intervista të thella me zyrtarë të institucioneve kyçe sa i përket sistemit gjyqësorit dhe prokurorial. Këtu janë përfshirë intervista me drejtues dhe zyrtarë të lartë të ndryshëm të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Sekretariatit të KGJK-së, KPK-së, Prokurorit të Shtetit, MD-së, Ministrisë së Administratës Publike (MAP), Gjykatave, Prokurorive, si dhe njohës të çështjeve të drejtësisë në Kosovë.

Të gjitha çështjet e ngritura nga udhëheqësit e institucioneve të drejtësisë janë inkorporuar në këtë analizë, e cila është bazuar në hulumtimin e detajuar të të gjitha akteve ligjore dhe përvojave të vendeve tjera, si dhe në parimet bazë të shëndosha nga demokracitë e zhvilluara, sipas të cilave funksionojnë pushtetet e pavarura.

Qeverisja në shtetet e ndryshme të botës nuk është e njëjtë për shkak të përvojës së gjatë të demokracisë nëpër ato vende. Kësisoj, ka qenë e vështirë të bëhet një krahasim i drejtpërdrejtë i praktikave, andaj në këtë studim janë marrë parasysh vetëm disa praktika të cilat do të ishin më të mirat për kontekstin e Kosovës.

3. HISTORIK I SHKURTËR I SISTEMIT GJYQËSOR NË KOSOVË

Ndërrimi i shpeshtë dhe rrënjësor i sistemeve të qeverisjes në dekadat e fundit në Kosovë ka pasur ndikim të madh në funksionimin e institucioneve të ndryshme shtetërore.⁶ Para vitit 1999, Kosova ka funksionuar nën Federatën e Jugosllavisë, ashtu që organizimi i organeve shtetërore, përfshirë këtu sistemin gjyqësor, ka qenë në përputhje të plotë me sistemin e kësaj federate. Duke pasur parasysh se Jugosllavia ka qenë sistem monist, ka qenë e pamundur të mendohet për ndarje dhe kontroll të mirëfilltë të pushteteve. Sistemi gjyqësor në Kosovë është rënduar tej mase me aplikimin e masave të dhunshme nga Serbia e Millosheviqit, sidomos pas fillimit të represionit.

Pasojat e këtyre akteve kanë çuar në amortizimin e shpejtë profesional të gjykatësve dhe prokurorëve si dhe ndërprerjen e mundësive për të zhvilluar kuadro të reja për gjyqësorin. Ndryshe nga sistemi arsimor paralel që kishte pasur mundësi të ngrihej gjatë një dekade, sistemi juridik e kishte të pamundur të ndërtohej dhe të funksiononte asokohe në atë mënyrë sa të prodhonte efektet e nevojshme juridike. Kjo ka bërë që hovi në zhvillimin e kuadrove në lëmin juridike të ndalet, ndërsa shumica e juristëve gjatë viteve '90 ia kishin mësyre avokaturës.

Pa dyshim se pasojat e para luftës janë reflektuar në ndërtimin e sistemit gjyqësor pas vitit 1999. Gjatë administratës së UNMIK-ut, në mungesë të kuadrove dhe të vlerësimeve adekuate të të gjithë kandidatëve të interesuar për t'u bërë pjesë e sistemit gjyqësor, ka qenë e vështirë që të eliminohen gjykatës dhe prokurorë me të kaluar të dyshimtë. Për shkak të praktikave të këqija të disa gjykatësve, qytetarët kishin humbur besimin në organet e drejtësisë.⁷

Në mungesë të vullnetit politik të akterëve vendorë dhe ndërkombëtarë, për vite të tëra kanë munguar hapat konkret drejt reformimit të sistemit gjyqësor. Në vitin 2005 është krijuar KGJK për të zëvendësuar Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës (KGJPK).⁸ Pas krijimit të KGJK-së që nga viti 2007 janë bërë përpjekje për të filluar procesin e riemërimit dhe emërimit të gjykatësve. Ky proces, që konsiderohej si më i rëndësishmi për reformën në drejtësi, kishte filluar tek në shkurt të vitit 2009.

Gjatë procesit të riemërimit dhe emërimit të gjithë kandidatët i janë nënshtruar testit të etikës dhe Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial (KPGJP) e ka bërë hetimin e detajuar të kaluarës së tyre, integritetit dhe pasurisë aktuale. Në tetor të vitit 2010, procesi ka përfunduar

⁶ Gjatë kësaj periudhe, sistemi i drejtësisë ka kaluar rrugë të gjatë e të mbushur me peripeci të shumta duke pasur parasysh federatën socialiste, regjimin e Millosheviqit, administrimi ndërkombëtar përmes UNMIK-ut dhe tani institucionet vendore të pavarura pas shpalljes së pavarësisë.

⁷ Gjyqësori është vendosur në majë të listave të institucioneve më jo efektive dhe të korruptuara në vend. Në bazë të raportit të Paralajmërimit të Hershëm të UNDP (maj-gusht 2002), 50% e të anketuarve janë shprehur se ekziston korupsion nëpër gjykata. Shih po ashtu, Fakte të Shpejta (2009) e paraqesin se qytetarët i perceptojnë gjykatat sikur njërin nga institucionet më të korruptuara. Raporti i Paralajmërimit të Hershëm (maj-gusht 2002) dhe Faktet e Shpejta (2009). UNDP.

⁸ Rregullore 2005/52, për Themelimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. UNMIK.

duke lënë pa plotësuar 127 pozita gjyqësore dhe prokuroriale.⁹ Shumë gjykatës dhe prokurorë që kishin shërbyer më parë në sistemin e drejtësisë, tanimë kishin rënë në integritet duke mos qenë të denjë për të ushtruar funksione në gjyqësor. Kjo ka krijuar hapësirë për të emëruar persona të rinj për të ndarë drejtësi, me rreth 60% të pozitave që u kanë ndarë gjykatësve dhe prokurorëve të rinj.¹⁰ Mos emërimi i gjykatësve dhe prokurorëve të cilët kishin shërbyer më parë, tregon se në sistemin e drejtësisë kanë shërbyer një numër i madh i personave të cilët vetëm se kanë rënduar këtë sistem.

Në frymën e reformimit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë, Kuvendi i Kosovës gjatë vitit 2010 kishte aprovuar katër ligje siq janë Ligji për Gjykatat, Ligji për KGJK-në, Ligji për Prokurorin e Shtetit, si dhe Ligji për KPK-në. Me këto ligje pritet që nga viti 2013 të fillojmë me një sistem të ri të organizimit të sistemit të gjykatave dhe prokurorive në vend. Përmes këtyre ligjeve është siguruar nivelizimi i pagave të gjykatësve dhe prokurorëve me ato të ministrave si dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka garantuar emërimin e tyre të përhershëm, gjë që plotëson kërkesat më bazike të pavarësisë të sistemit gjyqësor. Gjatë vitit 2011 dhe 2012 do të bëhen të gjitha përgatitje ashtu që në fillim të vitit 2013 të fillon zbatimi i këtyre katër ligjeve në tërësi.

⁹ Raporti mbi punën e Këshillit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial. Këshilli i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial. Tetor 2010.

¹⁰ Po aty.

4. DREJT NJË GJYQËSORI TË PAVARUR

*“Pavarësia e gjyqësorit duhet të jetë e vërtetë, e jo
veç sa për sy e faqe.”*

- Montesquieu

Modeli më i përhapur në shtetet demokratike bazohet në ndarjen e pushteteve, që në rrethana normale nënkupton tri degët e pushtetit duke përfshirë ekzekutivin, legjislativin, dhe gjyqësorin. Është e pamundur të flitet për ndarje në çdo aspekt pasi që ekzistojnë një numër i çështjeve që imponojnë ndërlidhjen dhe ndërveprimin e pushteteve. Andaj, një sistem demokratik i qeverisjes duhet të garantojë se pushtetet e ndryshme kanë fuqi dhe përgjegjësi të barabarta ashtu që të arrihet kontroll dhe balanc në mes njëra tjetrës.

Në shtetet me demokraci të papjekur, ku bën pjesë Kosova, pavarësia e gjyqësorit është thelbi i zgjidhjes së njejeve që paraqiten në sundimin e ligjit, gjë e cila do të siguronte pastaj funksionimin e ekonomisë së lirë, lirisë politike, zhvillimin e shoqërisë civile dhe avansimin e demokracisë.¹¹ Pavarësia e gjyqësorit perceptohet ndryshe nëpër shtete të ndryshme, prandaj është shumë e vështirë të bëhet një vlerësim krahasues dhe të nxjerret një model universal. Megjithatë, në raportin ‘Kombet në tranzicion’ sa i përket Kornizës dhe Pavarësisë Gjyqësore, Kosova e ka nivelin më të ulët të demokratizimit krahasuar me shtetet e tjera të rajonit dhe njëkohësisht progresi ndër vite ka qenë shumë i ngadalshëm.¹² Stagnimi apo progresi i ngadalshëm i Kosovës në këtë fushë mund të ndërlidhet ngushtë me kornizën ligjore e cila nuk ka siguruar pavarësinë e nivelit më të lartë si dhe veprimet e ekzekutivit që ndërhyjnë në punën e gjyqësorit.

Sistemi i Republikës së Kosovës është i themeluar mbi bazat e ndarjes së pushteteve. Një gjë e tillë garantohej me Kushtetutë, ku theksohet se “Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë.”¹³ Kapituj të veçantë të Kushtetutës përmbajnë dispozitat e qarta ligjore të cilat paraqesin rolin dhe përgjegjësitë e legjislativit, ekzekutivit, dhe gjyqësorit.¹⁴ Në bazë të Kushtetutës, në frymën e ndarjes së pushteteve, KGJK është institucioni i cili siguron pavarësinë e plotë në sistemin gjyqësor, duke përfshirë këtu rekrutimin dhe propozimin e gjykatësve, administrimin gjyqësor, punësimin dhe mbikëqyrjen

¹¹ Përfaqësuesi i Lartë në Bosnje dhe Hercegovinë, Ambasadori Paddy Ashdown, ka theksuar se “Në Bosnje, ne menduam se demokracia është prioriteti më i lartë dhe ne e matëm atë me numrin e zgjedhjeve që i organizonim. Më vonë kuptuam se do të duhej që të vendosim sundimin e ligjit prioritet pasi që gjithçka tjetër varet nga ai; funksionimi i ekonomisë, sistem politik i drejtë dhe i lirë, zhvillimi i shoqërisë civile, dhe besimi i publikut në polici dhe gjykata.” Gjetendet në http://www.judicialmonitor.org/archive_0207/inreview.html (qasar më 14 korrik 2011).

¹² Shih fusnotën 2.

¹³ Neni 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka vendosur dispozita të cilat janë në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare të cilat promovohen nga Organizata e Kombeve të Bashkuara. “Principet bazike për Pavarësinë e Gjyqësorit.” Organizata e Kombeve të Bashkuara. 1985, shih: <http://www2.ohchr.org/english/laë/indjudiciary.htm> (qasar më 14 qershor 2011).

¹⁴ Kapitulli IV [Kuvendi i Republikës së Kosovës], Kapitulli VI [Qeveria e Republikës së Kosovës], Kapitulli VII [Sistemi i Drejtësisë], dhe Kapitulli VIII [Gjykata Kushtetuese]. Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

e administratorëve të gjykatave, hartimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit për gjyqësorin.¹⁵ Nivelin më të lartë të gjykatave e përbën Gjykata Supreme dhe nën të renditen gjykatat e niveleve tjera më të ulëta. Ndërsa Gjykata Kushtetuese është e ndarë nga pjesa tjetër e sistemit gjyqësor dhe funksionon si e veçantë qoftë në llogaridhënie, kushte shtesë për përzgjedhje të gjykatësve, organizim të punës, si dhe përpilim dhe menaxhimin e buxhetit.¹⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka vënë themelet e mekanizmave të cilët në mënyrë të pavarur duhet të menaxhojnë pushtetin gjyqësor në vend. Megjithatë, janë ligjet përcjellëse të cilat deri në një masë kanë qar përpara këto dispozita por mbetet ende për t'u bërë ashtu që pavarësia e gjyqësorit të jetë e vërtetë.

Deri në aprovimin e ligjeve bazike të gjyqësorit ka pas shumë vonesa dhe peripeci të cilat tregojnë për ndikimin e pushtetit ekzekutiv në reformimin e mirëfilltë të sistemit të drejtësisë. Procesi i emërimit dhe ri-emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve kishte filluar në shkurt të vitit 2009 para se të krijoheshin kushtet e favorshme të punës nëpër gjykata dhe prokurori pasi që ligjet bazike ishin aprovuar tek në gusht dhe tetor 2010. Oferta e gjyqësorit dhe prokurorive nuk ishte aq joshëse sa të tërhiqte numër më të madh të personave që kishin kualifikime superiore në fushën e drejtësisë.¹⁷ Me gjithë këto peripeci, ligjet bazike që kanë hyrë në fuqi kanë shtyrë përpara një pjesë të madhe të kërkesave të Kushtetutës që ndërliken me pavarësinë e gjyqësorit dhe prokurorive.¹⁸ Nga viti 2011 deri në fund të vitit 2012, ligji për Gjykatat dhe për Prokurorin e Shtetit nuk zbatohet në tërësi por vetëm dispozitat sikurse që janë emërimi i përhershëm i gjykatësve dhe prokurorëve të riemëruar në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe çështja e nivelizimit të pagave të gjykatësve dhe prokurorëve me pozitë relevante në pushtetin ekzekutiv.¹⁹ Megjithatë, përveç rritjes së pagave, vetëm për gjykatësit dhe prokurorët, nuk ka asnjë beneficion ekuivalent, siç i gëzojnë drejtuesit në institucionet e ekzekutivit. Dispozitat e tërësishme të këtyre ligjeve pritet të hyjnë në fuqi në vitin 2013, kur edhe pritet që KGJK dhe KPK të bëjnë gati ristrukturimin e sistemit të gjykatave dhe prokurorive. Sistemi aktual do të ndryshoj në tërësi duke shndërruar kështu Gjykatat Komunale në Gjykata Themelore, do të krijohet Gjykata e Apelit dhe do të riorganizohet Gjykata Supreme.²⁰

Me themelimin e KPK-së në pjesën e parë të vitit 2011 ka filluar edhe bartja e kompetencave për menaxhimin e prokurorive nga MD-ja tek ky institucion, që është arritje e madhe drejt pavarësisë në administrimin e prokurorive.²¹ KPK është përgjegjës për rekrutimin, propozimin dhe disiplinimin e prokurorëve si dhe mbikëqyrjen e administrimit të punës së Prokurorive në Kosovë.²² Kështu, KGJK dhe KPK përbëjnë trupat më të lartë të menaxhimit të institucioneve të drejtësisë në vend dhe se të gjitha ligjet apo aktet tjera nënligjore duhet të

¹⁵ Kapitulli VII [Sistemi i Drejtësisë], Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ligji nr. 03/L-223.

¹⁶ Kapitulli VIII [Gjykata Kushtetuese], Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-121.

¹⁷ Intervistat e KIPRED-it me ekspertë juridik, korrik 2011.

¹⁸ Në vitin 2010 është bërë aprovimi i katër ligjeve bazike siç janë Ligji për Gjykata, për Prokurori, për KGJK, dhe për KPK.

¹⁹ Dispozitat ligjore që janë duke u aplikuar kanë të bëjnë me statusin e pagës së gjykatësve Neni 29, Paga dhe Kompensimi Gjyqësor. Ligji për Gjykatat, Ligji nr. 03/L-199.

²⁰ Ligji për Gjykatat, Ligji nr. 03/L-199 dhe Ligji për Prokurorin e Shtetit, Ligji nr. 03/L-225.

²¹ Intervistë e KIPRED-it me Kryeprokurorin e Shtetit, z. Ismet Kabashi, qershor 2011.

²² Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Ligji nr. 03/L-224.

reflektojnë mbi parimin e kontrollit dhe balancit të pushteteve dhe njëkohësisht pavarësinë e sistemit të drejtësisë.

Nën kupolën e MD-së tashmë janë themeluar dhe janë në rrugë për t'u funksionalizuar disa institucione të cilat në masë të madhe do të lehtësojnë punën e gjyqësorit dhe do të ndikojnë në reformën e përgjithshme, duke ofruar mundësi më të mira për qasje në drejtësi për qytetarët. Në këtë rrafsh, në proces të funksionalizimit janë sistemi i noterisë, sistemi i ndërmjetësisimit si dhe do të krijohet Akademia Gjyqësore. Provimi i jurisprudencës, pas tri vite ngecësh është funksionalizuar dhe organizimi i tij bëhet në baza të rregullta, duke krijuar mundësi për përgatitjen e gjeneratave të reja që t'ju bashkohen sistemit juridik në Kosovë.

Sipas planeve të MD-së, reformat në sistemin e drejtësisë do të thellohen me miratimin e ligjeve tjera me rëndësi që do të rregullojnë fusha të caktuara të drejtësisë siç janë: Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, Ligji për Konfiskimin e Pasurisë të Fituar me Vepër Penale (Ligji Anti-mafia), ndryshimet në Kodin Penal të Kosovës, ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale, Ligji për Detyrimet, ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Noterinë, Ligji për Përmbartime, si dhe Ligji për Përgjegjësinë Penale të Personave Juridik.²³

KIPRED konsideron se iniciativat dhe arritjet që janë bërë gjatë viteve të fundit e që u përmendën më lartë përmbajnë elemente shumë pozitive sa i përket pavarësisë së gjyqësorit. Përkundër dispozitave të qarta në Kushtetutë rreth ndarjes së pushteteve, ligjet përcjellëse sikurse Ligji për KGJK-në dhe KPK-në kanë përcaktuar dispozita që krijojnë varësi nga pushteti ekzekutiv. Problemi kryesor ka të bëjë me dy aspekte shumë të rëndësishme sikurse që është propozimi i buxhetit dhe organizimi i punës/punonjësve jo-gjyqësor nëpër gjykata dhe prokurori. Raporti i Progresit për vitin 2010 ka theksuar se “reforma e gjyqësorit, buxhetit, stafit, dhe trajnimeve” janë çështje strategjike për KGJK-në.²⁴ Duke pasur parasysh se kjo kërkesë i është drejtuar KGJK-së, ky mekanizëm mbetet që të angazhohet në këtë aspekt.

²³ Prioritetet e Ministrisë së Drejtësisë: Ministria e Drejtësisë në mandatin 2011-2014, do të ketë këtë koncept pune mbi bazën e 6 (gjashtë) prioriteteve. Ministria e Drejtësisë. Prill 2011.

²⁴ Raporti i Progresit 2010. Komisioni European. 2010.

5. STRUKTURA INSTITUCIONALE DHE MARRJA E VENDIMEVE

Kushtetuta e Republikës së Kosovës i ka dhënë autoritet dhe kompetenca të plota KGJK-së dhe KPK-së për të qeverisur sistemin e drejtësisë në Kosovë ashtu që të sigurojnë pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësor dhe prokurorial.²⁵ Përbërja, fushëveprimi dhe kompetencat e dy mekanizmave më të lartë në menaxhimin e gjykatave dhe prokurorive janë shtjelluar në detaje në ligjin për KGJK-në dhe ligjin për KPK-në.²⁶ KGJK dhe KPK kanë kompetenca për të bërë rekrutimin, propozimin për emërimin e gjykatësve dhe prokurorëve tek Presidenti, përcaktimin e numrit të prokurorëve dhe gjykatësve, zhvillimin e politikave dhe strategjive. Gjithashtu, këto dy institucione administrojnë prokuroritë dhe gjykatat dhe personelin e tyre, përgatisin dhe menaxhojnë buxhetin, ngritjen profesionale të prokurorëve dhe gjyqtarëve, dhe në përgjithësi tjera angazhime që ndërlidhen me funksionimin efikas dhe efektiv të prokurorive dhe gjykatave.²⁷ Të gjitha këto përgjegjësi paraqesin një fushëveprim shumë të gjerë të KGJK-së dhe KPK-së në sistemin e drejtësisë, duke bërë këta trupa përgjegjës kryesor për shkallën e efikasitetit të funksionimit të sistemit të drejtësisë në vend.

Anëtari	Kush e bën përzgjedhjen	Baza Ligjore
1 Gjykatës i Gjykatës Supreme	Gjykatësit e Gjykatës Supreme	Ligji për KGJK
2 Gjykatës i Gjykatës Supreme	Gjykatësit e Gjykatës Supreme	Ligji për KGJK
3 Gjykatës i Gjykatës së Apelit	Gjykatësit e Gjykatës së Apelit	Ligji për KGJK
4 Gjykatës i Gjykatës Themelore	Gjykatësit e Gjykatës Themelore	Ligji për KGJK
5 Gjykatës i Gjykatës Themelore	Gjykatësit e Gjykatës Themelore	Ligji për KGJK
6 Gjykatës *	Kuvendi i Kosovës	Kushtetuta
7 Gjykatës *	Kuvendi i Kosovës	Kushtetuta
8 Anëtar i Odës së Avokatëve	Kuvendi i Kosovës	Kushtetuta
9 Person**	Kuvendi i Kosovës	Kushtetuta
10 Gjykatës serb	Kuvendi i Kosovës	Kushtetuta
11 Person nga komuniteti Serb**	Kuvendi i Kosovës	Kushtetuta
12 Gjykatës nga komunitet tjera	Kuvendi i Kosovës	Kushtetuta
13 Person nga komunitet tjera**	Kuvendi i Kosovës	Kushtetuta

Tabela 1 - Përbërja e Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Sa i përket përbërjes së këtyre mekanizmave, Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka saktësuar deri në një masë përbërjen e KGJK-së duke u fokusuar më së shumti në anëtarët të cilët do të përzgjidhen nga ana e Kuvendit të Kosovës, ndërsa nuk bën asnjë interpretim për përbërjen e KPK-së duke lënë që një gjë e tillë të rregullohet me ligj.²⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka paraparë që Kuvendi i Kosovës të bëjë përzgjedhjen e tetë nga 13

²⁵ Shih: Kapitullin 8, Sistemi i Drejtësisë. Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

²⁶ Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ligji nr. 03/L-233 dhe Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Ligji nr. 03/L-224.

²⁷ Po aty.

²⁸ Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, KGJK duhet të ketë 13 anëtarë, ku pesë (5) nga ata zgjedhen nga gjyqësori ndërsa tetë (8) të tjerë zgjedhen nga Kuvendi i Kosovës. Në anën tjetër, për KPK-në nuk parasheh as numrin e anëtarëve të saj e as nuk vendos se kush do e bëjë zgjedhjen e anëtarëve. Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

anëtarët e KGJK-së. Në rastin e Kroacisë, një nga standardet për të përmbushur kërkesat për hyrje në Bashkimin Europian që ndërlidhet me kaptinën e gjyqësorit, është përzgjedhja e shumicës së anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kroacisë nga ana e vetë gjyqësorit.²⁹ Prandaj, emërimi i shtatë nga 11 anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kroacisë bëhet nga vetë gjyqësori.³⁰ Duke parë përvojën e Kroacisë dhe vendeve tjera, funksionimi i pushtetit gjyqësor në mënyrë të pavarur në Kosovë mbetet problem shqetësues në të ardhmen nëse Kuvendi i Kosovës bën përzgjedhjen e mbi 60% të anëtarëve të KGJK-së.

KGJK përbëhet nga 13 anëtarë, me kualifikime dhe ekspertizë profesionale, të cilët emërohen për një mandat pesëvjeçar.³¹ Nga 13 anëtarë sa janë gjithsej, tetë (8) prej tyre i emëron Kuvendi i Kosovës, ndërsa vetëm pesë (5) prej tyre emërohen nga vetë gjyqësori. Kryesuesi i KGJK-së, i cili zgjedhet nga anëtarët e KGJK-së, i drejtohet Kuvendit të Republikës së Kosovës së paku një herë në vit për të raportuar lidhur me sistemin gjyqësor.³² Siç duket Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe ligjet që ndërlidhen me këtë çështje kanë krijuar një ndërlidhje shumë të madhe të KGJK-së me Kuvendin e Kosovës. Edhe pse një pjesë e anëtarëve që do të zgjedhen nga Kuvendi i Kosovës do të jenë gjykatës, roli i Kuvendit në përzgjedhjen e anëtarëve të KGJK-së është mbivlerësuar dhe krijon rrezik për politizim të këtij mekanizmi. Tutje, tendencat e anëtarëve të Komisionit Parlamentar për Legjislacion që të ndryshojnë mënyrën e përzgjedhjes së anëtarëve të KGJK-së ashtu që në të ardhmen të gjithë anëtarët e KGJK-së t'i përzgjedh Kuvendi i Kosovës,³³ bie në kundërshtim me parimet dhe praktikën e ndarjes së pushtetit. Shqetësim të ngjashëm ndajnë edhe përfaqësuesit e lartë të KGJK-së si dhe Zyra Civile Ndërkombëtare (ICO) në Kosovë, për të cilët një gjë e tillë paraqet shkelje të ndarjes së pushteteve.³⁴

Kuvendi mund të keqpërdor rolin e tij në përzgjedhjen e anëtarëve të KGJK-së dhe të kërkojë të shtrijë ndikimin e vetë përtej kompetencave që ka në përzgjedhjen e anëtarëve, duke synuar që të ketë fjalën e vetë në vendimet që merren nga KGJK. Bazuar në aspiratat e Republikës së Kosovës për ndërtimin e një shteti ligjor ku pushtetet janë të ndara, pavarësia e gjyqësorit do të fuqizohet në rast se Kuvendi i Kosovës përzgjedh numër më të vogël të anëtarëve të KGJK-së, ndërsa gjyqësorit t'i mundësohet të zgjedhë nga radhët e veta shumicën e anëtarëve të KGJK-së. Kjo gjë duhet të bëhet gjithnjë në përputhje me dispozitat e caktuara në Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit (PGJZS), që kërkon plotësimin e vendeve të lira të punës apo të ulëseve të rezervuara për anëtarët e komuniteteve jo-shumicë.

²⁹ Arritja e objektivave në kaptinën 23 – Gjyqësori. Komiteti Kombëtar. Parlamenti i Kroacisë.

³⁰ Ligji mbi Këshillin Kombëtar Gjyqësor, ligji numër 3051. Parlamenti i Kroacisë.

³¹ Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ligji nr. 03/L-233.

* Në bazë të dispozitave kalimtare, këta dy anëtarë do të zgjidhen nga radhët e EULEX me aprovim të ZCN-së. Kërkohej vetëm njëri nga anëtarët të jetë gjykatës, ndërsa për anëtarin tjetër ka liri më të madhe të përzgjedhjes mirëpo në praktikë që të dy ndërkombëtarët e përzgjedhur janë gjykatës.

** Në bazë të ligjit për KGJK-në, neni 5, alinea 4, Anëtarë të Këshillit mund të jenë edhe personat që nuk janë gjykatës ose prokurorë, por që janë juristë të jashtëm, profesorë të universitetit ose profesionistë me përvojë relevante, së paku prej dhjetë (10) vjetësh dhe të cilët kanë njohuri për gjyqësorin e Kosovës. Profesionistët mund të emërohen edhe jashtë fushës juridike dhe mund të përfshijnë persona me ekspertizë në menaxhment, financa, teknologji informative ose shkenca sociale.

³² Neni 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës], Stuktura e anëtarëve të KGJK-së; ; Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nr. 03/L-223;

³³ Komunikim i KIPRED-it përmes telefonit me anëtarë të Komisionit Parlamentar për Legjislacion, gusht 2011. Si dhe komunikim i KIPRED-it përmes postës elektronike me zyrtarë të ICO-së, gusht 2011.

³⁴ Po aty.

Modeli i përbërjes së KPK-së është ndryshe prej atij të KGJK-së, pasi që Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka lejuar fleksibilitet që ligji për KPK-në të vendos dispozitat se si do të jetë përbërja e këtij këshilli. Shumica e anëtarëve të KPK-së përzgjidhen nga vet sistemi prokurorial, përkatësisht zyret e ndryshme të prokurorisë duke siguruar pavarësi më të madhe në marrjen e vendimeve të Këshillit. Në tabelën më poshtë është paraqitur përbërja e Këshillit dhe si bëhet përzgjedhja e anëtarëve.

Anëtarët	Propozimi	Përzgjidhja
1 Kryeprokurori i Shtetit		Ex-officio
2 Prokuror nga Prokuroria Speciale		Prokuroria Speciale
3 Prokuror nga Prokuroria e Apelit		Prokuroria e Apelit
4 Prokuror nga Prokuroria Themelore		Prokuroria Themelore
5 Prokuror nga Prokuroria Themelore		Prokuroria Themelore
6 Ministri i Drejtësisë		Ex-officio
7 Anëtar nga Oda e Avokatëve të Kosovës	Këshilli Ekzekutiv i Odës së Avokatëve	KPK
8 Profesor nga Fakulteti Juridik	Departamenti i Arsimit të Lartë	KPK
9 Përfaqësues nga Shoqëria Civile	OJQ-të	KPK

Tabela 2 - Përbërja e Këshillit Prokurorial të Kosovës

Njëri nga vendimet më të mëdha në sistemin e drejtësisë është përzgjedhja dhe shkarkimi i gjykatësve dhe prokurorëve. Sistemi gjyqësor dhe prokurorial ka pavarësinë e plotë në përzgjedhjen e gjykatësve dhe prokurorëve, e cila bëhet përmes KGJK-së dhe KPK-së dhe garantohet me aktin më të lartë juridik të vendit. Këto dy mekanizma të drejtësisë vetë organizojnë kriteret dhe të bëjnë propozimet për emërimet dhe shkarkimet të gjykatësve dhe prokurorëve, ndërsa emërimin e tyre e bën më pas Presidenti i Republikës së Kosovës³⁵, roli i të cilit është i kufizuar vetëm në rol formal.

Duke parë rolin vendimtar të KGJK-së dhe KPK-së në emërimin dhe shkarkimin e gjykatësve dhe prokurorëve është mase e nevojshme që të evitohet roli vendimmarrës i anëtarëve nga radhët e avokatëve dhe ekzekutivit gjatë procesit përzgjedhjes apo shkarkimit. Një gjë e tillë do të krijojë hapësirë për konflikt interesi në rastin kur avokati përzgjedh gjykatësin apo prokurorin dhe po ashtu ndërhyrje e ekzekutivit që do të mund të kushtëzonte përzgjedhjen e ndonjë gjykatësi apo prokurori. Ministri i Drejtësisë dhe përfaqësuesi i Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK) kanë hequr dorë nga pjesëmarrja në Komisionin Disiplinor.³⁶

Në praktikë emërimi formal nga ana e Presidentit të vendit ka mjaftuar që ta shfrytëzojë atë për të ndikuar direkt në eliminimin e emrave të caktuar, duke mos i dekretuar si gjykatës dhe duke mos dhënë asnjë shpjegim, siç kërkohet me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Ish-Presidenti në detyrë Jakup Krasniqi, nga lista për dekretim të gjykatësve, kishte larguar kandidatin e vetëm për kryetar të Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe tre emra tjerë, pa

³⁵ Neni 104 [Emërimi dhe Shkarkimi i Gjykatësve]; “Gjykatësit i emëron, riemëron dhe shkarkon Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës” - Kapitulli VII Sistemi i Drejtësisë; Kushtetuta e Republikës së Kosovës;

³⁶ Intervista e KIPRED-it me Zëvendëskryeministrin dhe Ministrin e Drejtësisë, z. Hajredin Kuçi, korrik 2011.

dhënë asnjë arsyetim mbi refuzimin e bërë duke e bërë këtë vendim mjaft misterioz, në kundërshtim me dispozitat ligjore, të cilat obligojnë Presidentin që brenda afatit prej 60-të ditëve të deklarojë arsyet e refuzimit ndaj KGJK-së.³⁷ Ende nuk dihen arsyet e mos dekretimit të këtyre personave dhe ky rast bëhet ende më shqetësues pasi që dosjet e këtyre katër kandidatëve janë zhdukur nga sirtarët e Presidencës, përkundër faktit se drejtuesit e KGJK-së ia kishin dorëzuar ato Presidencës, në kohën kur ishin emëruar gjykatësit dhe prokurorët në tetor të vitit 2010.³⁸ Një veprim i tillë është jashtë kompetencave të Presidentit të Republikës së Kosovës apo ndonjë zyrtari tjetër, mirëpo deri më tani nuk kemi parë ndonjë hetim që është ndërmarrë për të nxjerrë në pah fatin e këtyre dosjeve.

³⁷Intervistat e KIPRED-it me anëtarë të KGJK-së, qershor-korrik 2011. Po ashtu, emisioni “Jeta në Kosovë” - Ndikimet në sistemin gjyqësor, tetor 2010 - <http://www.jetanekosove.com/shikovideo/590/Al>. Kjo praktikë është në kundërshtim me nenin 18, alinea 2: “Nëse Presidenti i Kosovës refuzon të emërojë apo riemërojë cilindo kandidat, Presidenti siguron brenda afatit gjashtëdhjetë (60) ditor arsyet e refuzimit të tij ndaj Këshillit. Këshilli mund ta paraqesë edhe një herë tjetër kandidatin e refuzuar para Presidentit së bashku me arsyetimin në formë të shkruar, ose Këshilli mund të propozojë një kandidat tjetër”. KREU III – Rekrutimi, emërimi dhe caktimi i gjykatësve. Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ligji nr. 03/L-223;

³⁸ Intervistë e KIPRED-it me zyrtarët e Presidencës së Kosovës, korrik 2011.

6. BËRJA E POLITIKAVE DHE LIGJEVE

Kushtetuta e Republikës së Kosovës rregullon çështjen e nismave legislative ku këtë të drejtë ia jep një varg të institucioneve përfshirë këtu Presidencën, Qeverinë, Kuvendin, madje edhe qytetarët në qoftë se mbledhin dhjetëmijë nënshkrime, por jo edhe sistemin e drejtësisë gjegjësisht KGJK-në dhe KPK-në.³⁹ Udhëheqësit e sistemit të drejtësisë në Kosovë mbesin në pritje të pushteteve tjera për të siguruar ligje, ndryshim dhe plotësim të ligjeve të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në punën e tyre të përditshme. Me gjithë mungesën e kësaj të drejte, KGJK dhe KPK thirren që të zhvillojnë politika për funksionim më të mirë të gjykatave dhe prokurorive.⁴⁰ Në ligjin për KPK-në, kërkohet që KPK të dërgoj propozime tek Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria që ndërlidhen me sistemin prokurorial dhe luftimin e kriminalitetit⁴¹, që paraqet kahje pozitive në aspektin e hartimit të politikave dhe ligjeve adekuate në këtë fushë.

Përkundër mënyrave të shumta për nisma legislative, institucionet e ekzekutivit kanë qenë organet kryesore të cilat kanë hartuar dhe sponsorizuar ligje. Në mungesë të hapësirës ligjore për gjyqësorin për të iniciuar ligje, është kufizuar hapësira e këtyre organeve për të hartuar legjislacion adekuat për këtë sektor, ku rrjedhimisht qeveria përmes MD-së ka rregulluar fushën e veprimit të gjyqësorit përmes hartimit dhe sponsorimit të ligjeve kompetencë kjo e dhënë përmes ligjit.⁴² Madje edhe atëherë kur ligjet janë në procedurë të përpilimit, ndryshimit, apo plotësimit nga organet e ekzekutivit, ftesa i bëhet në mënyrë selektive gjykatësve apo prokurorëve për të marrë pjesë në grupet punuese duke anashkaluar hierarkinë e këtyre institucioneve.⁴³ Kësisoj kontributi i gjykatësve dhe prokurorëve në legjislacionin e përpiluar ndodhë të mos jetë qëndrimi zyrtar i institucionit.

Kjo mungesë e komunikimit ndërinstitucional, ka bërë që në grupet punuese hartues të legjislacionit për gjyqësorin, të jenë edhe gjykatës të cilët kanë rënë nga testi i etikës.⁴⁴ Ky është një fakt shqetësues, që duhet ngritur ndërmjet këtyre institucioneve, pasi është paradoksale që individë të cilët janë shpallur të padenjë për të qenë pjesë e gjyqësorit, të bëjnë politika për gjyqësorin përmes ligjeve. Për çdo problem të gjyqësorit organi i cili mund të adresoj këto probleme në ligjet ekzistuese apo krijimin e ligjeve të reja është MD-ja në kompetencën e së cilës është përpilimi i agjendës legislative. Në të kaluarën, kapacitetet e MD-së për të përpiluar dhe zbatuar politika në fushën e drejtësisë nuk kanë qenë të ndonjë niveli të kënaqshëm. Kjo praktikë është përmirësuar dukshëm gjatë mandatit të tanishëm qeverisës, ku prioritet u është dhënë kualitetit të ligjeve dhe politikave publike.⁴⁵

Nevojat dhe kërkesat për rregullimin e kornizës legislative në fushën e drejtësisë varen kryekëput nga ekzekutivi dhe vullneti i tyre politik për të përfshirë ligjet e kësaj fushe në

³⁹ Neni 79 [Nisma Legislative]. Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

⁴⁰ Neni 21, Funksionimi i Gjykatave. Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ligji nr. 03/L0-223. Dhe neni 4, Detyrat, Kompetencat dhe Kufizimet e Këshillit. Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Ligji nr. 03/L-224.

⁴¹ Neni 4, Detyrat, Kompetencat dhe Kufizimet e Këshillit, alinea 1.10. Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Ligji nr. 02/L-224.

⁴² Rregullore nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive. Pjesa 1, Shtojca 1, Ministria e Drejtësisë.

⁴³ Intervistat e KIPRED-it me anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, qershor 2011.

⁴⁴ Intervistat e KIPRED-it me anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, qershor 2011.

⁴⁵ Intervistë e KIPRED-it me Zëvendëskryeministrin e Kosovës dhe Ministrin e Drejtësisë, z. Hajredin Kuçi, korrik 2011.

agjendën legislative. Pas një dekade, fusha e drejtësisë ende çalon në aspektin legjislativ, dhe po ashtu mungojnë ligjet bazike në luftimin e krimit të organizuar dhe hetimin e thellë të pasurimit në mënyrë jo-ligjore. Në këtë frymë, kemi rastin e Ligjit për Luftimin e Krimit të Organizuar apo ndryshe të njohur si Ligji Anti-Mafia⁴⁶, ku përfaqësuesit më të lartë të gjyqësorit dhe Komisionit Parlamentar për Legjislacion kanë kërkuar që ky ligj të procedohet sa më shpejtë, por që në praktikë ende zvarritet si ide në organet e ekzekutivit. Mosekzistimi i ligjeve specifike kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit kanë kontribuar në mungesën e rezultateve në këtë luftë, gjë e cila theksohet nga krerët e gjyqësorit.⁴⁷ Për këtë çështje organet e gjyqësorit janë të hendikepuara të ndërmarrin ndonjë masë për të përmirësuar funksionimin e rendit dhe ligjit.

Në prill të vitit 2011, Qeveria e Republikës së Kosovës merr vendim për krijimin e Këshillit Konsultativ për Drejtësi, në përbërjen e të cilit do të jenë vetëm pesë përfaqësues nga gjyqësori dhe prokuroria, ndërsa pjesa tjetër prej 13 anëtarësh do të përbëhet nga institucionet e tjera.⁴⁸ Ky vendim i qeverisë është shqetësim i madh rreth ndarjes së pushteteve në Kosovë dhe tendencës së vazhdueshme të ekzekutivit që të ketë nën kontroll pushtetet tjera.⁴⁹ Emërtimi i Këshillit për Drejtësi si Konsultativ, bazuar në përbërjen dhe dispozitat e tij, nuk reflekton vetëm rolin këshillëdhënës për pushtetin e tretë në vend. Në nenin 9 të këtij vendimi të Qeverisë saktësohet se për cdo veprim në aspektin e politikëbërjes së MD-së, KPK-së, si dhe KGJK-së të merret paraprakisht mendimi nga Këshilli për Drejtësi, mendim ky i cili duhet të përkrahët nga shumica e anëtarëve të Këshillit. Vendimi i Qeverisë përcakton detyrimet e institucioneve të jurisprudencës, ku obligon institucionet e drejtësisë, duke përfshirë MD-në, KPK-në dhe KGJK-në, që çdo propozim për projekt-aktet ligjore në fushën e judikaturës, fillimisht të dërgohen në Këshillin Konsultativ për të marrë mendim.⁵⁰ Çdo akt ligjor ku përfshihen strategjitë, projektligjet, dhe politikat e ndryshme duhet të kalojnë përmes këtij këshilli dhe opinionin e këshillit vendoset me shumicë votash të anëtarëve prezent.⁵¹ Edhe pse parashihet që 18 anëtarët e Këshillit për Drejtësi të vijnë nga institucione të ndryshme, të gjithë do të emërohen nga Qeveria e Kosovës.⁵² Në këtë fillim, anëtarëve të

⁴⁶ Sipas strategjisë legislative për vitin 2011 të Zyrës së Kryeministri, Ligji për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar parashihet të procedohet në Zyrën për Shërbime e Ndihmës Juridike më së largu me 1 nëntor 2011. Strategjia Legjislative për vitin 2011. Zyra e Kryeministrit të Kosovës. Gjetet në http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Legjislative_2011-finale-_e_plotesuar_me_25.05.2011_.pdf (qasur më 14 qershor 2011).

⁴⁷ Sipas gjykatësve, prokurorëve dhe hetuesve infrastruktura e tanishme ligjore paraqet problem të madh për të mbledhur dëshmi lidhur me atë nëse materialet e caktuara janë përfitur në mënyrë të paligjshme pasi që barra e provës bie mbi shërbimet prokuroriale dhe ato të zbatimit të ligjit. Fuqizimi i Sundimit të Ligjit në Kosovë II: Konfiskimi i pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme. KIPRED. Prishtinë: prill 2011.

⁴⁸ Vendimi për themelimin e Këshillit Konsultativ për Drejtësi, Vendimi nr. 04/13. Qeveria e Republikës së Kosovës. 29 prill 2011.

⁴⁹ Përveç varësisë së gjyqësorit, në dyshim vihet edhe pavarësia e legjislativit, pasi që Qeveria në vazhdimësi kritikohet për ushtrim të kontrollit. Llapashtica, Jeton. Kuvendi nën "thundrat" e Qeverisë. Zëri. Gjetet në <http://www.zeri.info/artikulli/1/1/27951/kuvendi-nen-thundrat-e-qeverise/> (qasur më 15 korrik 2011).

⁵⁰ Neni 9, Vendimi mbi Themelimin e Këshillit Konsultativ për Drejtësi, Vendimi nr. 04/13. Qeveria e Republikës së Kosovës. 29 prill 2011.

⁵¹ Neni 4, alinea 2, Vendimi mbi Themelimin e Këshillit Konsultativ për Drejtësi, Vendimi nr. 04/13. Qeveria e Republikës së Kosovës. 29 prill 2011.

⁵² Neni 3, alinea 2, i vendimit të Qeverisë për Këshillin për Drejtësi thekson qartë se emërimi i anëtarëve do të bëhet nga ana e Qeverisë së Kosovës. Mirëpo, MD në njoftimin e drëguar institucioneve relevante për pjesëmarrje në Këshillin për Drejtësi ka kërkuar që ato të zgjedhin vetë përfaqësuesit e tyre që do të jenë pjesë e Këshillit. Vendimi mbi Themelimin e Këshillit Konsultativ për Drejtësi, Vendimi nr. 04/13. Qeveria e Republikës së Kosovës. 29 prill 2011. Si dhe intervistat e KIPRED-it me zyrtarë të lartë të institucioneve të cilat janë ftuar të marrin pjesë në Këshillin Konsultativ për Drejtësi, qershor-korrik 2011.

paraparë për të qenë pjesë e Këshillit për Drejtësi iu është kërkuar që emërimin e përfaqësuesve ta bëjnë vetë, mirëpo dispozita në vendimin e Qeverisë thekson qartë se vetë Qeveria do të emëroj këta anëtarë.⁵³ Duke parë se shumicën e Këshillit e përbëjnë përfaqësuesit që nuk vijnë nga gjyqësori, kjo mund të interpretohet si ndërhyrje e drejtpërdrejtë në punët e gjyqësorit, pasi përfaqësuesit e këtij pushteti nuk do të mund të ndërmarrin asnjë hap në rregullimin ligjor të fushës së tyre, përfshi aktet ligjore, rregullative apo normative pa marrjen e opinionit të Këshillit Konsultativ. Kjo përpjekje e ekzekutivit paraqet ndërhyrje direkte në fushat të cilat i janë dedikuar ekskluzivisht gjyqësorit dhe prokurorive.⁵⁴

	Përfaqësuesi	Emërimin e bën	Përfaqësues të Sistemit Gjyqësor dhe Prokurorial
1	Zëvendëskryeministri (që merret me sundimin e ligjit)	Qeveria e Kosovës	
2	Ministri i Drejtësisë	Qeveria e Kosovës	
3	Anëtar i Komisionit Parlamentar për Legjislacion	Qeveria e Kosovës	
4	Presidenca e Kosovës	Qeveria e Kosovës	
5	Zyra Civile Ndërkombëtare	Qeveria e Kosovës	
6	EULEX	Qeveria e Kosovës	
7	OSBE	Qeveria e Kosovës	
8	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	Qeveria e Kosovës	1
9	Këshilli Prokurorial i Kosovës	Qeveria e Kosovës	1
10	Prokurori i Shtetit	Qeveria e Kosovës	1
11	Gjykata Supreme	Qeveria e Kosovës	1
12	Gjykata Kushtetuese	Qeveria e Kosovës	1
13	Universiteti i Prishtinës (Fakulteti Juridik)	Qeveria e Kosovës	
14	Universiteti i Prishtinës (Fakulteti Juridik)	Qeveria e Kosovës	
15	Universiteti i Prishtinës (Fakulteti Juridik)	Qeveria e Kosovës	
16	Instituti Gjyqësor i Kosovës	Qeveria e Kosovës	
17	Shoqëria Civile	Qeveria e Kosovës	
18	Oda e Avokatëve të Kosovës	Qeveria e Kosovës	

Tabela 3 – Përbërja e Këshillit Konsultativ për Drejtësi⁵⁵

⁵³ Intervistat e KIPRED-it me zyrtarë të lartë të institucioneve të cilat janë ftuar të marrin pjesë në Këshillin Konsultativ për Drejtësi, qershor-korrik 2011.

⁵⁴ Sipas nenit 4 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i cili flet mbi kompetencat dhe përgjegjësitë e KGJK-së, ky i fundit është institucioni më i lartë që ka mandat për të krijuar politika për punën e sistemit gjyqësor. Edhe neni 4 i ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës parashihet që KPK të jetë organ i cili zhvillon politika dhe strategjitë për sistemin prokurorial në vend. Shih edhe deklaratën e Z. Fejzullah Hasani në artikullin e gazetës *Zëri*. Shih Bajrami S., “Qeveria edhe mbi gjyqësorin”. *Zëri*. 1 korrik 2011.

⁵⁵ Vendimi mbi Themelimin e Këshillit Konsultativ për Drejtësi, Vendimi nr. 04/13. Qeveria e Republikës së Kosovës. 29 prill 2011

Vendimi i qeverisë është bërë me konsultim minimal me institucionet të cilat obligohen të marrin pjesë në këtë mekanizëm, posaçërisht me organet e gjyqësorit.⁵⁶ Qeveria e Kosovës e ka arsyetuar këtë hap duke fajësuar organet udhëheqëse të drejtësisë për pasivitet dhe duke u thirrur në një nevojë për bashkëpunimin ndërinstitucional në forcimin e sundimit të ligjit⁵⁷, gjë që në të kaluarën kishte munguar dhe sigurisht që ka lënë pasojë në sistemin e drejtësisë. Mirëpo, krijimi i trupave përmbi mekanizmat e drejtësisë sikurse që janë KGJK dhe KPK, të cilët janë të paraparë me Kushtetutë vetëm sa e kthen mbrapa të gjithë procesin e ndërtimit të pavarur të gjyqësorit. Si rrjedhojë kemi edhe sabotimin për pjesëmarrje në Këshillin Konsultativ për Drejtësi nga ana e pushtetit gjyqësor.⁵⁸ Përbërja e KGJK-së dhe KPK-së është e larmishme gjë që siguron thënie të një spektri të gjerë të hisedarëve në përpilimin e politikave për sistemin gjyqësor dhe prokurorial. Vendimi i qeverisë pikë së pari është në kundërshtim me Ligjin për KGJK dhe Ligjin për KPK dhe si i tillë ndërhyr në pavarësinë e zhvillimit të politikave të gjyqësorit për të siguruar efikasitet në punën e vet si dhe në punën e sistemit prokurorial që të zhvilloj politikat dhe strategjitë adekuate për funksionimin e sistemit dhe luftimin e krimit.

Duke konsideruar se përmes këtij Këshilli ndërhyhet në pushtetin gjyqësor, Presidenca e Kosovës, ka vendosur të delegojë përfaqësuesin e vet në kapacitet të vëzhguesit pa të drejtë vote.⁵⁹ Nga të gjithë përfaqësuesit e drejtësisë, Kryeprokurori i Shtetit është i vetmi institucion që nuk e sheh si ndërhyrje krijimin e këtij mekanizmi këshillëdhënës mbi prokurorinë⁶⁰, i cili tashmë ka deleguar përfaqësuesin e tij. Ndryshe nga gjyqësori i pari i Prokurorit të Shtetit njëherësh kryesuesi i KPK-së, ku anëtar i kësaj të fundit ex-oficio është Ministri i Drejtësisë, këtë e sheh si mekanizëm këshillëdhënës.⁶¹ Përkundër natyrës këshillëdhënëse të këtij Këshilli, vet përbërja e tij ka karakter influencues në bërjen e politikave të gjyqësorit. Anëtarët e këtij këshilli që vijnë nga pushteti gjyqësor, do të ndjehen të intimiduar dhe nën presion të ekzekutivit gjatë punëve të këtij këshilli. Kësisoj, vet ekzistenca e tij në këtë përbërje është në kundërshtim me parimet e ndarjes së pushteteve, meqë pushtetet duhet të jenë të pavarura në thelb, e jo sipërfaqësisht. MD e ka futur këtë Këshill për Drejtësi si prioritet të parë⁶² për mandatin 2011-2014, por, edhe dy muaj pas marrjes së këtij vendimi, mbetet e paqartë zbatueshmëria e tij si pasojë e hezitimit të institucioneve të gjyqësorit për t'u mbledhur në këtë Këshill.

⁵⁶ Intervistat e KIPRED-it me zyrtarë të lartë të institucioneve të cilat janë ftuar të marrin pjesë në Këshillin Konsultativ për Drejtësi, qershor-korrik 2011.

⁵⁷ Intervistë e KIPRED-it me Zëvendëskryeminstriin dhe Ministrin e Drejtësisë, z. Hajredin Kuçi, qershor 2011.

Kryeprokurori i Shtetit, që tashmë ka deleguar përfaqësuesin e vet në Këshillin për Drejtësi, thekson se një nga problemet me hartimin e ligjeve që e prekin gjyqësorin ka të bëjë me përsëritjen e veprave të njëjta penale në disa ligje, sikurse që është rasti me sulmin ndaj zyrtarit publik që përmendet në disa ligje. Andaj lind nevoja për hartimin e një legjislacioni unik, duke evituar gabimet që kanë ndodhur në të kaluarën, ku për shembull për një vepër të njëjtë penale, cilësimi është bërë në mënyra të ndryshme në ligje të ndryshme. Intervistë e KIPRED-it me Kryeprokurorin e Shtetit, z. Ismet Kabashi, qershor 2011.

⁵⁸ Deri me datën 8 qershor 2011, Qeveria e Kosovës nuk ka marrë përgjigje nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Gjykata Supreme e Kosovës, Presidenca e Kosovës, EULEX, dhe akterë tjerë.

⁵⁹ Intervistë e KIPRED-it me përfaqësues të Zyrës së Presidentes së Kosovës, qershor 2011.

⁶⁰ Intervistë e KIPRED-it me Kryeprokurorin e Shtetit, z. Ismet Kabashi, qershor 2011.

⁶¹ Intervistë e KIPRED-it me Kryeprokurorin e Shtetit, z. Ismet Kabashi, qershor 2011.

⁶² Prioritetet e Ministrisë së Drejtësisë: Ministria e Drejtësisë në mandatin 2011-2014, do të ketë këtë koncept pune mbi bazën e 6 (gjashtë) prioritetëve. Ministria e Drejtësisë. Prill 2011.

7. PËRFAQËSIMI JOADEKUAT

Në prill të vitit 2011, Ministri i Drejtësisë ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi me Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ), së cilës i lejohet qasje në monitorimin e proceseve gjyqësore⁶³, kompetencë kjo e KGJK-së.⁶⁴ Kryesuesi i KGJK-së konsideron se nënshkrimi i këtij memorandumi dhe të tjerëve të ngjashëm nga përfaqësuesit e ekzekutivit për sferën e gjyqësisë është i papranueshëm dhe paraqet ndërhyrje në punën e gjyqësorit.

Gjatë vitit 2010, brenda Zyrës së Prokurorisë Speciale të Kosovës (ZPSK) është krijuar Task-Forca kundër Korrupsionit. Kjo Task-Forcë ka ardhur pas një vendimi të Qeverisë së Kosovës dhe në konsultim minimal me Prokurorinë e Shtetit apo KGJK-në, që në atë kohë ka qenë përgjegjës për politikën sa i përket gjyqësorit dhe prokurorive të shtetit.⁶⁵ Përkundër publicitetit të madh për formimin e kësaj task-force, përkrahja financiare nga ana e Qeverisë së Kosovës kishte munguar pothuajse edhe tetë muaj pas formimit të kësaj task-force.⁶⁶ Në anën tjetër me vendim të Kryeprokurorit të Shtetit, është krijuar një task-forcë tjetër brenda zyrave të prokurorive. Në secilën prokurori është caktuar një prokuror që do të merret me rastet e korrupsionit.⁶⁷ Qeveria e Kosovës, përmes këtyre vendimeve ndërhyrje direkt në politikën e ndjekjes së veprave të caktuara penale nga Prokurori i Shtetit. Ndryshe, praktikën e mira tregojnë për një qasje më të drejtë në raport me pushtetin gjyqësor dhe prokuroritë, të cilave ju ofrohen kushte të punës dhe buxhet i mjaftueshëm për luftimin e ndonjë dukurie. Por, nuk vendosin sikurse rasti i Qeverisë së Kosovës në lidhje me Task-Forcën kundër korrupsionit, pa konsultim paraprak me institucionet përgjegjëse, për të parë kapacitetet aktuale dhe mënyrën e ngritjes së tyre me qëllim që të arrihen rezultatet e pritura.

Në prioritetet 2011 – 2014, MD planifikon punë që nuk ndërlidhen me fushë-veprimtarinë dhe kompetencat e veta, duke i zgjeruar ato në sferën e gjyqësorit. Prioriteti i parë është koordinimi i sundimit të ligjit, të cilin e kishte planifikuar përmes krijimit të Këshillit Konsultativ për Drejtësi. Kjo tregon për një praktikë e cila duhet të ndryshojë në politikëbërjen e ekzekutivit, pasi që KGJK dhe KPK janë mekanizmat kryesor që thirren për të bërë koordinimin e sundimit të ligjit në Kosovë. Në vazhden e prioritetëve 2011-2014 të MD-së, ngrihen edhe disa çështje të cilat i takojnë KGJK-së dhe KPK-së, ndërsa roli i MD-së është mjaft i kufizuar. MD zotohet që të punoj në implementimin e ligjeve bazike të gjyqësorit siç janë Ligji për Gjykatën, për Prokurorinë e Shtetit, për KGJK, dhe për KPK, duke mundësuar funksionalizimin dhe strukturimin e gjykatave dhe prokurorive. Tutje, MD e sheh si përgjegjësi të veten rritjen e numrit të gjykatësve dhe prokurorëve në vend, në përputhje

⁶³ “Ministria e Drejtësisë dhe KMDLNJ nënshkruan memorandum mirëkuptimi”. Ministria e Drejtësisë. Gjetet në <http://www.md-ks.org/?page=1,8,349> (qasur më 1 korrik 2011). Dhe KIPRED komunikim me Z. Behxhet Shala, Drejtor Ekzekutiv, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut. 14 qershor 2011.

⁶⁴ Neni 4, alinea 1.22. Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ligji nr. 03/L-223.

⁶⁵ Intervistat e KIPRED-it me Kryeprokurorin e Shtetit, z. Ismet Kabashi, dhe Kryetarin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, z. Enver Peci, qershor dhe shtator 2010. Shih po ashtu, “Fuqizimi i Sundimit të Ligjit në Kosovë: Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.” KIPRED. Prishtinë: nëntor 2010.

⁶⁶ Intervistë e KIPRED-it me Kryeprokurorin e Shtetit, z. Ismet Kabashi, qershor 2010. Shih po ashtu, Qosaj-Mustafa, Ariana. “Fuqizimi i Sundimit të Ligjit në Kosovë: Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.” KIPRED. Prishtinë: nëntor 2010.

⁶⁷ Intervistë e KIPRED-it me Koordinatorin e Lëndëve të Korrupsionit, znj. Drita Hajdari, qershor 2011.

me nevojat dhe standardet ndërkombëtare. Në bazë të kornizës ligjore, KGJK dhe KPK janë institucionet të cilat bëjnë planifikime bazuar në nevojat dhe kërkesat që kanë gjykatat dhe prokuroritë për t'iu përgjigjur shërbimeve të qytetarëve në mënyrë sa më efikase. Andaj, çdo tendencë e MD-së për t'u përzier në implementimin e këtyre ligjeve do të jetë ndërhyrje e ekzekutivit në gjyqësor.

Një nga aspektet pozitive në bërjen e ligjeve dhe politikave është mundësia e rishikimit të ligjeve nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për të vendosur për përputhshmërinë e ligjeve, rregulloreve të Qeverisë dhe çështjeve tjera me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.⁶⁸ Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe janë mbi ligjet apo ndonjë akt tjetër ligjor. Kërkesa për çështje të caktuara mund të ngrihet nga institucione si Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria, Avokati i Popullit, Komunitat, deputetët e Kuvendit, individët, apo gjykatat. Sistemi i tillë siguron se sistemi i drejtësisë në Kosovë i është mundësuar rishikimi i akteve ligjore dhe nënligjore. Gjykata Kushtetuese tashmë veç ka zbatuar këto dispozita ligjore sikurse që është rasti me Ligjin për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetëve, ku Gjykata Kushtetuese merr vendim për masë të përkohshme sa i përket pensioneve për deputetët e Kuvendit të Kosovës.⁶⁹ Kjo praktikë vetëm sa ka shtuar besueshmërinë në GJK për t'u përballur me rastet e profileve më të mëdha politike e institucionale. Opinioni vendor dhe ndërkombëtar tashmë ka parë pavarësinë dhe guximin e gjykatësve të kësaj gjykate, ku ndër të tjera kanë gjykuar dy raste kontesti rreth zyrës së parë të shtetit, asaj të Presidentit të Republikës.

⁶⁸ Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

⁶⁹ Vendimi për masë të përkohshme në rastin nr. KO 119/10. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.

8. PËRPILIMI DHE MENAXHIMI I BUXHETIT

Përkrahja e vogël financiare e gjyqësorit vërehet më së miri me buxhetin që i është ndarë këtij pushteti, i cili deri në vitin 2011, kur është bërë rritja e pagave për gjykatës, ka qenë rreth 14 milionë Euro, apo më pak se 1.15% e buxhetit të përgjithshëm të shtetit.⁷⁰ Praktika e deritanishme tregon se asnjë propozim buxhetor i KGJK-së nuk është aprovuar si i tillë por gjithnjë ka kaluar propozimi i cunguar nga Qeveria e Kosovës⁷¹, i cili ka qenë buxhet minimal. Në të njëjtën gjendje kanë qenë edhe prokuroritë e shtetit ku gjatë vitit 2010, institucioni i Prokurorit të Shtetit ka shpenzuar vetëm 6,094 Euro në muaj.⁷² Buxheti i vogël për gjykata dhe prokurori ka sjellur probleme të shumta. Këtu përfshihen nevojat e mëdha për staf profesional jo-gjyqësor, renovime të gjykatave, siguria e dobët për gjykatës dhe palët tjera që marrin pjesë në procese gjyqësore, si dhe çështje tjera të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e punës së gjyqësorit si dhe qasjen në drejtësi për qytetarët.

KGJK dhe KPK me ligjet përkatëse obligohen që buxhetin ta dorëzojnë direkt në Qeveri, ndërsa më pas propozimit të tyre do t'i bashkëngjitet edhe propozimi i Ministrisë së Financave dhe bashkërisht i dorëzohen Kuvendit të Kosovës.⁷³ Kjo është një mënyrë e re e propozimit të buxhetit për KGJK-në, pasi që në të kaluarën Kuvendi i Kosovës ka pranuar vetëm propozimin e përgatitur nga Qeveria e Kosovës. Përkundër ndryshimit të mënyrës së propozimit të buxhetit për sistemin gjyqësor dhe prokurorial në Kuvendin e Kosovës, nuk pritet të ketë ndonjë ndryshim në praktikën e ndarjes së buxhetit pasi që koalicioni qeverisës përbën shumicën në Komisionin Parlamentar për Buxhet dhe në Kuvendin e Kosovës. Kuvendi i Kosovës, duke pasur mundësinë që të zgjedhë në mes të buxhetit të propozuar nga KGJK apo KPK dhe atij të propozuar nga Qeveria e Kosovës sa i përket sistemit gjyqësor dhe prokurorial, do të veproj sikurse në të kaluarën ku pa asnjë ndryshim ka aprovuar versionin e propozuar nga Qeveria e Kosovës duke injoruar kërkesat që vijnë direkt nga gjyqësori dhe prokuroritë.

Ndryshe nga KGJK dhe KPK, Ligji për KGJK-në dhe KPK-në kërkon që Zyra e Prokurorit Disiplinor (ZPD), mekanizëm i përbashkët i tyre, buxhetin ia propozon direkt Kuvendit të Kosovës.⁷⁴ Pra, rasti i kësaj zyreje tregon qartë tendencat e vazhdueshme për krijimin e pavarësisë së mekanizmave të gjyqësorit dhe prokurorisë sa i përket pavarësisë në aspektin buxhetor. Megjithatë, është paradoksale fakti që KGJK dhe KPK komunikimin rreth buxhetit duhet adresojnë fillimisht në Qeveri, ndërsa ZPD që është mekanizëm brenda këtyre institucioneve është më e pavarur se vetë institucionet qendrore të drejtësisë. Një gjë e tillë vetëm sa komplikon situatën në planifikimin dhe menaxhimin e ZPD-së nga ana e drejtuesve të pushtetit gjyqësor.

⁷⁰ Për 3 vite (për vitin 2009, 2010, dhe 2011) gjyqësorit i është ndarë buxhet prej rreth 44 milionë euro. Shih tabelën Kërkesat financiare të KGJK-së dhe alokimi i fondeve.

⁷¹ Qeveria e Kosovës për mandatin 2008-2011, kishte deklaruar se sundimi i ligjit si një nga prioritetet kryesore, duke e vendosur atë menjëherë pas energjisë dhe minierave dhe transportit. Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2008-2011. Zyra e Kryeministrit. Prill 2008.

⁷² Intervistë e KIRPED-it me Kryeprokurorin e Shtetit, z. Ismet Kabashi, qershor 2010.

⁷³ Neni 15, Propozimi i buxhetit vjetor. Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ligji nr. 03/L-223. Poashtu, neni 13, Buxheti. Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Ligji nr. 03/L-224.

⁷⁴ Neni 49, Buxheti për zyrën e Prokurorit Disiplinor. Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ligji nr. 03/L-223. Poashtu, neni 39, Buxheti për Zyrën e Prokurorit Disiplinor. Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Ligji nr. 03/L-224.

Ligji për KGJK-në kërkon që KGJK të përpilojë një propozim të buxhetit për vitin 2012 dhe ai të dorëzohet në Qeveri. Përkundër kësaj dispozite, Qeveria e Kosovës ka dërguar kufijtë buxhetor për linja të ndryshme buxhetore që sinjalizon se nuk kemi të bëjmë me një proces të planifikimit nga KGJK por praktika e njëjtë do të vazhdojë në të ardhmen. Kufijtë buxhetor nga ana e Qeverisë asnjëherë nuk i janë përgjigjur nevojave të gjyqësorit të vlerësuara nga ana e KGJK-së.⁷⁵ Për vitin 2012, KGJK ka kërkuar buxhet prej 20.8 milion Euro, i cili është më i lartë se ai i lejuar me qarkore të dërguara nga Qeveria, në mënyrë që të sigurohet funksionimi efektiv i gjykatave gjatë vitit 2012.⁷⁶ Për çdo vit, kërkesat e KGJK-së kanë qenë shumë më të larta se buxheti i aprovuar, ku për vitin 2009 janë aprovuar 10 milionë Euro më pak se kërkesa fillestare, në vitin 2010 afër 4 milionë Euro më pak, ndërsa në vitin 2011 afër 2 milionë Euro më pak.⁷⁷ Nëse analizohen të gjitha kërkesat financiare të KGJK-së dhe buxheti i aprovuar, vërehet se ka shkurtesa të mëdha në linjat të paraqitura nga ana e KGJK-së.

Viti	Kërkesat e KGJK-së		Buxheti i aprovuar	Ndryshimi i buxhetit të aprovuar nga kërkesa fillestare	Buxheti për KGJK kundrejt buxhetit shtetëror
	I-rë (fillestare)	II-të (përfundimtare)			
2009	24,387,209.20	15,234,488.73	13,420,708.00	10,966,501.20	1.18%
2010	17,527,166.60	15,901,140.00	14,088,590.00	3,438,576.60	1.14%
2011	18,914,466.00	-	17,000,892.00	1,913,574.00	1.20%
2012	20,872,115.00	-	-	-	-

Tabela 4 - Kërkesat financiare të KGJK-së dhe alokimi i fondeve⁷⁸

Buxheti për KGJK-në luan rol të madh në të gjithë organizimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të duhur të gjykatave, administrimit gjyqësor, me theks të veçantë mbikëqyrjen e administratorëve dhe administratës së gjykatave.⁷⁹ KGJK është përgjegjëse për planifikimin dhe realizimin e duhur të buxhetit ashtu që të siguroj funksionim efikas të gjykatave. Ligji kërkon që personeli gjyqësor të trajnohet nga KGJK në bashkëpunim me Institutin Gjyqësor të Kosovës (IGJK), shoqatat dhe organizatat tjera trajnuese. Në këtë menaxhim kërkohet që KGJK të sigurojë efektivitet dhe efikasitet të gjykatave. Kryetarët e Gjykatave Themelore kanë kompetenca të autorizojnë punësimin, masat disiplinore dhe përfundimin e personelit gjyqësor.⁸⁰

⁷⁵ Intervistë e KIPRED-it me Kryetarin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, z. Enver Peci, qershor 2010.

⁷⁶ Po aty.

⁷⁷ Shih Tabelën 4 – Kërkesat Financiare të KGJK-së dhe alokimi i fondeve.

⁷⁸ Komunikim i KIPRED-it përmes postës elektronike me Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, gusht 2011.

⁷⁹ Neni 4, Ligji i KGJK-së.

⁸⁰ Neni 24 mbi Përgjegjësitë e Kryetarit të Gjykatës, Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, ligji numër 03/L-223.




Figura 1 – Grafik krahasimor rreth kërkesave të KGJK-së dhe buxhetit të aprovuar

Për shkak të rritjes së pagave për gjykatësit, siç kërkohet me Ligjin e ri për Gjykatat, buxheti i përgjithshëm i KGJK-së për vitin 2011 është rritur prej atij të vitit 2010 për 3 milionë Euro.⁸¹ Përveç kësaj rritje, nuk është vërejtur ndonjë përmirësim tjetër në financimin e gjykatave. Brengosës është fakti që për vitin 2012 dhe 2013, Ministria e Financave ka paraparë zvogëlim të fondeve për gjyqësor ku në tabelat e buxhetit për vitin 2013 ka parashikuar zvogëlimin e fondit për gjykatat deri në 15.96 milionë Euro.⁸²

Shembull:

Gjykata Kushtetuese gëzon pavarësinë në përpilimin dhe menaxhimin e buxhetit të saj dhe si e tillë rregullon të gjitha çështjet në mënyrë të pavarur. Pavarësia e Gjykatës Kushtetuese është më e madhe se e ndonjë organi tjetër pasi që buxheti i saj dërgohet direkt në Kuvendin e Kosovës dhe nuk lejohet ndërhyrja e Qeverisë së Kosovës apo ndonjë organizate buxhetore.⁸³ Në aspektin praktik, liritë që gëzon Gjykata Kushtetuese reflektohen në pavarësinë e plotë dhe efikasitetin e punës së tyre.⁸⁴

Sa i përket prokurorive, menaxhimi i të gjitha funksioneve administrative dhe buxhetore deri më tani është kryer nga MD. Me formimin e KPK-së, këto funksione janë në përfundim të transferimit tek Drejtoria e Përgjithshme brenda Prokurorit të Shtetit, dhe deri në konsolidimin e kësaj drejtorie, MD do të vazhdoj të mbështes atë. Një nga gjërat pozitive në formimin e Drejtorisë së Përgjithshme dhe mekanizmave tjerë që do i shërbejnë KPK-së

⁸¹ Shih tabelën për kërkesat financiare të KGJK-së dhe alokimi i fondeve

⁸² Tabelat e Buxhetit për vitin 2011. Ministria e Financave.

⁸³ Neni 14, Buxheti. Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-121.

⁸⁴ Intervistë e KIPRED-it me Zyrtar Ligjor në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, qershor 2011.

është edhe transferimi i zyrtarëve nga MD tek Prokurori i Shtetit për shkak të njohurive me proceset e punës në menaxhimin e prokurorive të shtetit të cilën gjë e kanë bërë që nga krijimi i MD-së. Përkundër kësaj dukurie është shumë e rëndësishme që stafi i mëparshëm i MD-së të përshtatet me ambientin e institucionit të Prokurorit të Shtetit dhe të ketë parasysh se ky institucion është i pavarur nga ekzekutivi ashtu që në të gjitha aktivitetet e tyre duhet të reflektohet kjo pavarësi.

Investimet infrastrukturore për prokuroritë janë përgjegjësi e ekzekutivit. Deri më datën 9 mars 2011 projektet e kësaj natyre kanë qenë nën menaxhimin e Ministrisë së Drejtësisë, dhe pas kësaj date fondet kanë kaluar nën menaxhimin e Ministrisë së Administratës Publike. Ky institucion ka staf të kualifikuar të përbërë nga inxhinier dhe profesionist që do t'i menaxhonin më së miri proceset e përpilimit të specifikave, tenderimit, dhe mbikëqyrjes së projekteve.⁸⁵ Duke pasur parasysh se sa luajnë rol investimet kapitale në funksionimin e prokurorive, ky arsyetim nuk mundet të jetë i qëndrueshëm dhe të minimizohet efekti i varshmërisë. Kjo varësi paraqet problem dhe krijon hapësirë për ndërhyrje në sistemin e drejtësisë, siç është shembulli i një projekt për ndërtimin e Prokurorisë së Qarkut në Pejë⁸⁶, i cili është duke u zvarritur që një kohë të gjatë ndërsa mjetet janë të siguruara.

Edhe në këtë aspekt, vende të ndryshme ndjekin praktika të ndryshme. Hungaria ka qenë vendi i parë në Europën Qendrore e cila ka transferuar kompetencat nga MD-ja tek Këshilli i formuar nga organet e gjyqësorit për menaxhimin dhe administrimin e gjyqësorit. Deri në vitin 2002, planifikimi i buxhetit është bërë nga një mekanizëm i pavarur i gjyqësorit dhe i është dorëzuar qeverisë për ta rishikuar dhe proceduar më tutje për aprovim në Parlament. Duke parë se në vazhdimësi ky buxhet është tkurrur nga qeveria, është vendosur që të ndryshohet praktika e përpilimit të buxhetit për gjyqësorin duke lejuar kështu që KGJK të dërgoj direkt propozimin për buxhet në Parlament.⁸⁷ Raporti i njëjtë tregon se është rritur efikasiteti dhe njëkohësisht është siguruar pavarësi më e lartë e institucioneve gjyqësore, siç ceket "... sistemi i ri funksionon në mënyrë efikase dhe ka rezultuar në pavarësi të theksuar të gjyqësorit".⁸⁸

Përvoja e keqe në të kaluarën e gjyqësorit të Kosovës si dhe përvojat e vendeve tjera të cilat kanë praktikuar metodën e njëjtë të propozimit të buxhetit, jep sinjale të qarta se metoda më e mirë është që propozimi i buxhetit të shkoj direkt nga organet e gjyqësorit tek ato të legjislativit, pa ndonjë ndërhyrje të ekzekutivit. Kjo është mënyra e vetme që të sigurohet se vlerësimi i nevojave të gjyqësorit është duke u bërë në mënyrë adekuate dhe se përgjegjësinë për financimin e gjyqësorit do e mbajnë direkt legjislativi, të zgjedhurit e popullit.

Për të lënë plotësisht në duar të atyre që thirren për të menaxhuar sistemin e drejtësisë në Kosovë, është shumë e arsyeshme që investimet kapitale të kalojnë në mekanizmat sikurse që

⁸⁵ Intervistë e KIPRED-it me Sekretarin Permanent e Ministrisë së Administratës Publike, z. Fitim Sadiku, korrik 2011.

⁸⁶ Intervistë e KIPRED-it me Kryeprokurorin e Shtetit, z. Ismet Kabashi, korrik 2011. Në bazë të tabelave të buxhetit të Ministrisë së Financave për vitin 2010, ekzistojnë mjetet e ndara për projektin e prokurorisë së qarkut në Pejë. Sekretari i Përhershëm i MAP deklaroi se ky investim është në proces të tenderimit dhe së shpejti do të bëhet edhe hapja e ofertave. Korrik 2011.

⁸⁷ "Analiza e Draft Ligjit në Departamentin e Administratës Gjyqësore në Republikën e Moldavisë." ABA CEELI. Mund të gjendet në http://apps.americanbar.org/rol/publications/moldova_analysis_draft_laë_jud_%20admin.pdf (1 korrik 2011)

⁸⁸ Po aty.

janë KGJK dhe Prokurori i Shtetit. Në këtë mënyrë do të evitohen prolongimet në krijimin e kushteve të punës pa arsye, sikurse që është rasti me Prokurorinë e Qarkut të Pejës. Pa marrë parasysh ekspertizën e punonjësve të MAP apo ndonjë dikasteri tjetër qeveritar, ekspertiza për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të prokurorive dhe gjykatave kërkon njohuri më të specializuara se ato standarde pasi që kemi të bëjmë edhe me avancimin e sigurisë dhe çështjeve tjera në këto ndërtesa.

9. PERSONELI DHE ADMINISTRATA

Roli i KGJK-së në rregullimin e punës së gjykatave kufizohet edhe më tutje kur është puna në organizimin dhe menaxhimin e stafit jo-gjyqësor. Problemet që krijojnë varësi e pengesa në funksionimin e mirëfilltë të sistemit gjyqësor dhe prokurorial lindin në Ligjin për Shërbimin Civil pjesë e të cilit janë punonjësit jo-gjyqësor të gjykatave dhe prokurorive. Asnjë veprim në drejtim të ristrukturimit të brendshëm të stafit apo ndërrimeve të koeficienteve të tyre nuk mund ta bëjnë udhëheqësit e KGJK-së dhe KPK-së pa miratimin e ekzekutivit.⁸⁹ Kjo pa dyshim se reflekton në pavarësinë dhe efikasitetin e dobët të sistemit të drejtësisë. Pavarësia në menaxhimin e resurseve njerëzore cungohet qoftë edhe në rastin e një pozite më të ultë sikurse ajo e pastruesit për të cilën duhet të marrë aprovim nga MAP, kërkesa e të cilit duhet të kalojë nëpër sirtarët e disa zyrtarëve brenda kësaj ministrie deri në vendimin përfundimtar.⁹⁰ Ndikimi i ekzekutivit në gjykata sa i përket aspektit të punonjësve jo-gjyqësor mund të ilustruhet me rastin e 2 majit 2011 kur punonjësit e Gjykatës Komunale në Prishtinë vendosën të hyjnë në grevë për shkak se rritja e pagave nuk u realizua ashtu sikurse që u premtua nga Kryeministri i Kosovës.⁹¹ Fatkeqësia më e madhe në këtë rast ishte se komunikimi zhvillohej në mes të punonjësve të gjykatave dhe ekzekutivit, ndërsa KGJK dhe trupat e saja kishin një rol minimal. Kjo ishte si pasojë e asaj se ekzekutivi kishte përpiluar politikën për trajtimin e punonjësve të gjykatave.

Në bazë të rregullores së brendshme të Gjykatës Kushtetuese, për çështjet administrative sikurse që është buxheti, personeli, kushtet e punësimit, kompensimi, organizimi i brendshëm dhe funksionimi i gjykatës, dhe çështje tjera vendosen gjatë seancave administrative që udhëhiqen nga gjykatësit.⁹² Në aspektin praktik, liritë që gëzon Gjykata Kushtetuese reflektohen në pavarësinë e plotë dhe efikasitetin e punës së tyre.⁹³ Rregullorja e brendshme po ashtu specifikon mënyrën dhe kushtet për përzgjedhjen e Sekretarit të Përgjithshëm, ku komisioni për vlerësim përbëhet nga tre gjykatës.⁹⁴ Përveç punëtorëve të cilët cilësohen staf civil, Gjykata Kushtetuese mund të rekrutoj edhe Këshilltar Ligjor për të cilët bëhet kontratë e posaçme dhe lihet jashtë Ligjit mbi Shërbimin Civil, dhe se vendimi për emërimin apo shkarkimin e një këshilltari ligjor merret me shumicën e votave të gjykatësve prezent në Gjykatën Kushtetuese.⁹⁵ Edhe në aspektin e caktimit të pagave liria e Gjykatës Kushtetuese është mjaft e lartë ku një këshilltar Juridik ka pagën fikse prej 505 euro dhe merr shtesa 300 euro në saje të së drejtës së kësaj gjykate për të menaxhuar në mënyrë të pavarur dhe efikase buxhetin. Kjo gjykatë është i vetmi institucion i gjyqësorit i cili gëzon këtë të drejtë siç thuhet për shkak të rëndësisë së institucionit. Rrjedhimisht, kjo gjykatë stimulon dhe tërheq kuadrot

⁸⁹ Intervistat e KIPRED-it me Drejtorin e Sekretariatit të KGJK-së, z. Albert Avdiu, si dhe U.D. Drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Prokurorit të Shtetit, z. Shkëlzen Maliqi, qershor 2011.

⁹⁰ Po aty.

⁹¹ Administrata në grevë. Klan Kosova. Gjendet në <http://klankosova.tv/index.php/lajme-nga-vendi/7055-administrata-negreve.html> (qasur më 1 korrik 2011).

⁹² Rregulli 14 Seancat Administrative, Rregullorja nr 185/1/2010, Rregullore e Punës e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

⁹³ Intervistat e KIPRED-it me Zyrtar Ligjor në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, qershor 2011.

⁹⁴ Rregulli 16 Sekretari i Përgjithshëm, Rregullorja nr 185/1/2010, Rregullore e Punës e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

⁹⁵ Rregulli 14 Këshilltarët Ligjorë, Rregullorja nr 185/1/2010, Rregullore e Punës e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

deficitare sikurse që janë juristët të cilët përfshihen në kapacitet të bashkëpunëtorëve profesional e të këshilltarëve juridik. Andaj, është mëse e nevojshme që i gjithë sistemi gjyqësor të ketë mundësinë për të rekrutuar dhe për të hartuar strategji të karrierës për këto kuadro të vlefshme të cilat në të ardhmen mund të jenë kandidatë potencial për të ushtruar funksione të larta gjyqësore.

Shembull:

Administratori i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, për vitin 2010 kishte kërkuar 10 punonjës mirëpo i ishte mundësuar të punësonte vetëm një. Ndërsa për vitin 2011 për shkak të rritjes së numrit të gjykatësve është bërë kërkesa për 14 punonjës shtesë dhe ende nuk ka pas ndonjë përgjigje për këtë.⁹⁶ Në vitin 2005, Gjykata e Qarkut në Prishtinë ka pasur 63 punonjës ndërsa me vendim të Qeverisë në vitin 2008 është marrë vendim për reduktimin e 12 pozitave në këtë gjykatë.⁹⁷ Kjo sigurisht që ka ndikuar në punën e gjykatës duke shtyrë që punonjësit të mbingarkohen me punë. Zvogëlimi i stafit ka ardhur si pasojë e tkurrjes së linjës për paga dhe mëditje në propozimin e buxhetit që Qeveria e Kosovës kishte dërguar në Kuvendin e Kosovës.

Në tabelën më poshtë është paraqitur injorimi i kërkesave të bëra nga gjyqësori për pozita administrative, ndryshe që njihen edhe si pozita jo-gjyqësore. Në këto pozita përfshihen edhe bashkëpunëtorët profesional.

Viti	Numri i pozitave administrative (jo-gjyqësore)		
	Kërkesa e KGJK-së	Të lejuara me buxhet	Ndryshimi në mes të kërkesës dhe aprovimit
2008	1629	1383	246
2009	1609	1383	226
2010	1846	1530	316
2011	1969	1530	439

Tabela 5 - Krahasimi i kërkesave dhe pozitave të lejuara për stafin jo-gjyqësor

Pushteti ekzekutiv për të sajuar hendekun sa i përket pagave të vogla të shërbyesve civil, ka krijuar fondin për kuadro i cili alokohet për stimulimin e personave në pozita strategjike. Zyra e Kryeministrit rezervon të drejtën për të alokuar këtë fond aty ku e sheh të nevojshme. Praktika e deritashme flet se interes strategjik i ekzekutivit nuk ka qenë ndërtimi dhe mbajtja e kapaciteteve në sistemin gjyqësor. Bazuar në misionin dhe rëndësinë që ka sistemi i drejtësisë në sigurimin e sundimit të ligjit, problemi ky kryesor në Kosovë, shtrohet dilema pse ka më pak rëndësi sesa ekzekutivi.

⁹⁶ Intervistë e KIPRED-it me Administratorin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, z. Feriz Berisha, qershor 2011.

⁹⁷ Gjykata e Qarkut në Prishtinë mbulon 50% të lëndëve të përgjithshme të nivelit të qarkut, duke ju shërbyer afër 1 milion banorëve të Kosovës. Intervistë e KIPRED-it me Administratorin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, z. Feriz Berisha, prill 2011. Shih po ashtu Fuqizimi i Sundimit të Ligjit në Kosovë II: Konfiskimi i pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme. KIPRED. Prishtinë: prill 2011.

Kompleksiteti i çështjes së punonjësve jo-gjyqësorë shtrihet në disa fusha, duke përfshirë këtu trajtimin jo të njëjtë në mes të punonjësve të pushtetit gjyqësor dhe të ekzekutivit. MAP përdor standarde të dyfishta për përcaktimin e koeficienteve. Një paradoks i tillë vërehet edhe në rastin kur për pozitën e njëjtë vendosin koeficientë të ndryshëm pavarësisht faktit që detyrat, përgjegjësitë, dhe kualifikimet janë të njëjta. Ky paradoks mund të vërehet po të krahasohen kërkesat për pozita të njëjta që ka bërë KPK dhe KGJK.⁹⁸ Nga krahasimi i pagave për pozita të ngjashme në mes të pushteteve vërehet se nuk ka ndonjë nivelizim racional. E vetmja pozitë që është avancuar për sa i përket koeficientit në raport me pushtetin ekzekutiv është pozita e Drejtorit të Sekretariatit të KGJK-së e cila është ekuivalente me atë të Sekretarve Permanent të Ministrive. Përveç kësaj, pozitat tjera janë në shpërputhje dhe vërehet diskrepancë në mes të pushteteve, ku përfaqësuesit e gjyqësorit janë në pozita më të pavolitshme sa i përket koeficientëve. Po të merret një drejtor i departamentit në ndonjë ministri, ai/ajo ka koeficient 10, ndërsa administratorët e gjykatave kanë koeficient 8.5 dhe 8. Po të analizohen detyrat dhe përgjegjësitë vërehet se puna e punonjësve nëpër gjykata e prokurori është shumë më e ndjeshme dhe komplekse sesa puna e punonjësve nëpër institucione të ekzekutivit. Megjithatë, ekzekutivi vazhdon të shfrytëzojë mjetet për administratën e vetë dhe i kushton rëndësi më të vogël punonjësve nëpër gjykata.

	Koeficienti
Sekretari Permanent (Ekzekutiv)	20
Sekretari i KGJK-së (Gjyqësor)	20
Drejtori i Departamentit (Ekzekutiv)	10
Administratori në Gjykatën Supreme	9
Administratori i Gjykatës së Qarkut (Gjyqësor)	8.5
Administratori i Gjykatës Komunale (Gjyqësor)	8

Tabela 5 - Krahasimi i koeficientëve të gjyqësorit dhe ekzekutivit

Praktika e tillë e llogaritjes së pagave pa dyshim se ka ndikuar edhe përbrenda sistemit gjyqësor. Administratori i Gjykatës së Qarkut e ka koeficient prej 8.5 ndërsa ata të Gjykatës Komunale kanë koeficientin 8. Nuk dallon koeficienti për nga ngarkesa e gjykatës me lëndë.⁹⁹ Kështu, përafërsisht rroga mujore e administratorit arrin në 400 euro e cila është diku 30% e pagës së Kryetarit të Gjykatës. Në periudhën 1974 - 1989, Sekretari i Gjykatës ka kryer funksionin e Administratorit të sotëm. Njëra nga kërkesat kryesore për pozitën e Sekretarit ka qenë kualifikimi i lartë në fushën përkatëse. Paga e Sekretarit të Gjykatës ka qenë 80% e pagës së Kryetarit të Gjykatës, apo e njëjtë me Gjykatësit e Gjykatës Komunale.¹⁰⁰ Ndërsa paga e Bashkëpunëtorit Profesional ka qenë 70% e pagës së Gjykatësit.

⁹⁸ MAP për pozitën e njëjtë në të dy institucionet Sekretariatit e KGJK-së dhe Prokurorinë e Shtetit, ka vendosur koeficient të ndryshëm ku në KGJK për pozitën e zyrtarit të transportit ka aprovuar koeficientin 8.5 ndërsa për pozitën e njëjtë në Drejtori të Përgjithshme të Prokurorit të Shtetit fillimisht ka aprovuar koeficientin 6 ndërsa pas insistimit të të kësaj të fundit ai është rritur në 7. Intervistat e KIPRED-it me zyrtarë të lartë në Sekretariatit e KGJK-së dhe Prokurorinë e Shtetit, qershor-korrik 2011.

⁹⁹ Gjykata Komunale në Prishtinë gjatë tremujorit të parë 2011 ka në punë 57,580 lëndë. Gjykata Komunale në Dragash gjatë tremujorit të parë 2011 ka në punë 911 lëndë. Megjithatë, të dy administratorët e këtyre gjykatave marrin pagën e njëjtë përkundër volumit disproporcional të punës. Statistika e gjykatave të rregullta, raporti tre mujor 2011. Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

¹⁰⁰ Intervistë e KIPRED-it me Administratorin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, z. Feriz Berisha, qershor 2011.

Tendenca për të mbajtur të varur institucionin e prokurorisë nga ana e ekzekutivit ka ekzistuar qysh në fillet e përpilimit të Ligjit mbi KPK-në. Në draftet e ndryshme të këtij ligji, vazhdimisht është insistuar nga hartuesit që kompetencat për administrimin dhe menaxhimin e prokurorive të mos ndaheshin në mënyrë të qartë nga MD. Madje në njërin nga draftet e Ligjit mbi KPK-në parashihej që Kryesues i KPK-së të jetë Ministri i Drejtësisë.¹⁰¹ Në të njëjtën kohë, parashihej që MD të ketë kompetenca menaxhuese me stafin mbështetës të Prokurorive.

Si duket pasojat e këtyre tendencave kanë lënë gjurmë dhe paqartësi në ligjin aktual i cili nuk specifikon mënyrën e zgjedhjes së Drejtorit nga KPK duke lënë kështu varësi që kjo të rregullohet përmes Ligjit për Shërbimin Civil. Ligji për Prokurorin e Shtetit kërkon që Kryeprokurori i Shtetit të ofroj mbështetje administrative për KPK-në.¹⁰² Meqë ligji nuk e qartëson përzgjedhjen e Drejtorit të Sekretariatit, ka lënë hapësirë që një drejtor i tillë të zgjidhet në bazë të Ligjit për Shërbim Civil. Prandaj, ekzistojnë paqartësi rreth funksionimit të Sekretariatit të KPK-së pasi që modeli i KGJK-së nuk ka mundur të aplikohet në rastin e KPK-së sepse ligji mbi Prokurorin e Shtetit thekson se përmes një sekretariati të vendosur në institucionin e Prokurorit të Shtetit duhet t'i ofrohet përkrahje administrative KPK-së.¹⁰³ I vetmi rast ku përmendet fjala sekretariat i KPK-së është në nenin 14 të Ligjit për KPK, dhe në asnjë pjesë tjetër të ligjit.

Nën mandatin e Prokurorit të Shtetit, KPK aktualisht është në proces të krijimit të kapaciteteve njerëzore dhe kushteve të punës. Problemet fillestare në këtë drejtim ndërliken ose shpërfaqin ndërhyrjet e ekzekutivit në ndërtimin e KPK-së. Për çdo kërkesë që ndërliken me strukturimin e organogramit të Drejtorisë së Përgjithshme të Prokurorit të Shtetit duhet të kërkohej aprovim nga organet e ekzekutivit, përkatësisht MAP.¹⁰⁴ Kjo varësi nuk është dispozitë kalimtare por është e bazuar në dispozitat e Ligjit mbi Shërbimin Civil dhe mungesën e qartësisë në ligjin mbi Këshillin Prokurorial. Në këtë të fundit në asnjë dispozitë nuk qartësohet mënyra e zgjedhjes së Drejtorit, i cili do të kryej funksionin ekuivalent me atë të Drejtorit të Sekretariatit të KPK-së, por ai zyrtarisht do të jetë Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Prokurorit të Shtetit. Përzgjedhja e drejtorit duhet të bazohet në harmoni të plotë me Ligjin mbi Shërbimin Civil. Sipas këtij ligji, për emërimin e pozitave të larta të shërbyesve civil, formohet komisioni në përbërje të shtatë (7) anëtarëve ku përfshihen tre (3) sekretarë permanentë, një (1) profesor nga fakulteti juridik nga lëmia përkatëse, një (1) përfaqësues i shoqërisë civile, dhe dy (2) zyrtarë të përzgjedhur nga institucioni i titullarit. Sipas kësaj, rezulton se me rastin e përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm të Prokurorit të Shtetit, komisioni reflekton më shumë interesa të ekzekutivit sesa të vetë institucionit të prokurorisë. Kjo paraqet ndërhyrje në funksionimin e pavarur të Prokurorit të Shtetit.

Në frymën e varësisë nga pushteti ekzekutiv, Drejtori i Përgjithshëm i Prokurorit të Shtetit është i detyruar që të marrë aprovim nga ky pushtet madje edhe për transferet e punonjësve.

¹⁰¹ Intervistë e KIPRED-it me anëtarë të grupit punues në hartimin e ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, qershor 2011.

¹⁰² Neni 12 mbi Rolin administrative të zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Ligji për Prokurorin e Shtetit, ligji numër 03/L-225.

¹⁰³ Intervistë e KIPRED-it me U.D. Drejtorin e Përgjithshëm të Prokurorit të Shtetit, z. Shkëlzen Maliqi, qershor 2011.

¹⁰⁴ Po aty.

Mungesa e fleksibilitetit për të menaxhuar punonjësit në mënyrë të pavarur i shtyn eprorët që të ngarkojnë punonjësit e tyre me detyra jashtë atyre të parapara në përshkrimin e vendit të punës.¹⁰⁵ Trajtimi i punonjësve të gjykatave dhe prokurorive me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil dhe funksionimi i ndërlikuar për këta punonjës nga SKGJK dhe Drejtoria e Përgjithshme e Prokurorit të Shtetit në raport me MAP, paraqet pengesa serioze në efikasitetin e punës së tyre dhe rrjedhimisht ndërhyrje në funksionimin e brendshëm.

Një segment tjetër, në të cilin MD ka kompetenca direkt në fushën e gjyqësorit janë Zyrat Ndërlidhëse të Gjykatave, nëpër qendra të vogla të Kosovës. Edhe pse këto zyra pothuajse asnjëherë nuk ishin funksionalizuar siç ishte planifikuar, duhet analizuar nëse ato duhet të shuhen në tërësi apo të kalojnë nën kompetencë të KGJK-së. MD në 2005 kishte themeluar 11 Zyra Ndërlidhëse të Gjykatave, funksioni i të cilave ishte menduar të jetë sigurimi i qasjes më të mirë në drejtësi përmes ofrimit të shërbimeve për qytetarët e komuniteteve pakicë në Kosovë, duke përfshirë dërgimin e vendimeve gjyqësore, ftesave për gjykata, dhe çështje tjera. Këto zyra parashihet të funksionojnë në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, ndërsa roli i tyre i përket ekskluzivisht fushës së gjyqësorit.

Një seri e çështjeve që mund të cilësohen si teknike për Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial, siç janë shembull çështja e emailave, serverëve, linjave telefonike etj duhet të trajtohen me urgjencë, për shkak se ato në thelb reflektojnë një lloj varshmërie të këtij pushteti ndaj ekzekutivit. Aktualisht, si KGJK ashtu edhe KPK, i kanë adresat elektronike me prapashtesën e njëjtë të institucioneve të ekzekutivit siç është @ks-gov.net, ndërsa serverët janë të përbashkët dhe gjenden në MAP. Po ashtu, prefikset e linjave telefonike nuk dallojnë nga ato të Qeverisë së Kosovës. Duke e parë këtë varshmëri teknike në dukje, përfaqësues të Prokurorit të Shtetit dhe SKGJK-së tani më kanë filluar që të ndërmarrin hapa rreth këtyre çështjeve që më në fund secili pushtet të ketë në pronësi dhe të identifikohet si i pavarur.

¹⁰⁵ Intervistë e KIPRED-it me punonjës të gjykatave dhe prokurorive, qershor 2011.

10. NDËRHYRJET POLITIKE NË PROCESET GJYQËSORE

Ndërhyrjet politike në sistemin e drejtësisë në Kosovë nuk janë fenomen i ri. Në fakt, raportet e vazhdueshme të progresit të Komisionit Evropian, si dhe shumë studime tjera të organizatave ndërkombëtare, e kanë cekur interferimin politik si një nga sfidat kryesore për forcimin e sundimit të ligjit në Kosovë.

Interferimet e tilla janë fillimisht pasojë e mentalitetit të së kaluarës, sipas të cilit, ekzekutivi mbanë primatin për gjithçka. Prej vitit 1999 e deri më sot, ka patur dhjetëra raste kur prokurorët e gjykatës u janë bindur qeverisë për çfarëdo vendimi, ani pse nuk janë pajtuar domosdoshmërisht me të. Një rast i ngjashëm është edhe rasti i Kryeprokurorit të Shtetit, i cili ka vendosur që të pranojë Këshillin Konsultativ për Drejtësi, ani pse ekzistenca e këtij këshilli dëshmohej të jetë e panevojshme dhe pjesëmarrja në të është bojkotuar nga institucionet relevante të drejtësisë. Në vazhdim, do të analizohen tri raste specifike që njëherit janë indikatorët më të mirë të tri fenomeneve të ndërhyrjeve politike në gjyqësor.

10.1. *Nënshtrimi i gjyqësorit*

Falë mentalitetit të së kaluar, mungesës së guximit dhe mungesës së etikës profesionale, shumë prokurorë e gjykatës bien pre e vetcenzurës apo nënshtrimit gjatë ushtrimit të funksionit të tyre. Kësisoj, shumë raste të veprave të rënda penale, madje edhe vrasjeve, janë hedhur poshtë nga prokuroritë e gjykatat e Kosovës vetëm për shkak se në to kanë qenë të involvuar figura të fuqishme të jetës politike. Një rast ilustrues është edhe rasti i fundit gjyqësor në Gjykatën Komunale të Prishtinës, në të cilin gjykatësja vendore Anita Krasniqi-Prenaj ka refuzuar të gjykojë një lëndë. Subjekt i lëndës ishte Kryeministri i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, i cili ishte paditur privatisht për shpifje dhe zbulim të rrethanave personale dhe familjare, nga deputeti i Lëvizjes “Vetëvendosje” Florin Krasniqi. Gjykatësja e lëndës Krasniqi – Prenaj kishte kërkuar që lënda të gjykohej nga gjykatësit ndërkombëtarë të EULEX-it me arsyetimin se akterët kryesor të kësaj çështje penale janë persona me funksione të larta politike në Kosovë. Për gjykimin e kësaj lënde, Gjykata Komunale në Prishtinë ka mbajtur mbledhje të kolegjiut të gjykatësve, ku sërish ka munguar guximi për ta gjykuar atë. Pas kësaj, ushtruesja e detyrës së kryetares së kësaj gjykate, znj. Makifete Saliuka, i ka kërkuar EULEX-it që ta marrë lëndën në shqyrtim për ta gjykuar, dukë dhënë të njëjtat arsye sikurse edhe gjykatësja Krasniqi – Prenaj.¹⁰⁶ Kjo dëshmon për një situatë ku parimet e së drejtës nuk zbatohen në mënyrë të barabartë nga arbitrat vendor. Ndërsa fenomeni është aq i përhapur, sa që gjykatat kanë filluar që lëndët t’i ndajnë me short, e jo me radhë apo me ndonjë sistem tjetër të ndarjes së punës.¹⁰⁷ E gjithë kjo është pikë së pari dëshmi e mungesës së guximit profesional ndër gjykatës, por edhe indikator i një atmosfere të pavolitshme për të ushtruar detyrën e gjykatësit në Kosovë.

¹⁰⁶ Intervista e KIPRED-it me gjykatës në Gjykatën Komunale të Prishtinës, korrik 2011.

¹⁰⁷ Intervista e KIPRED-it me gjykatës në Gjykatën Komunale të Prishtinës, korrik 2011.

Me këtë rast, gjykatësja bie ndesh me betimin e dhënë me rastin e dekretimit të saj si gjykatëse për ndarjen e drejtësisë dhe zbatimin e ligjit në mënyrë të barabartë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, ndër të cilët është edhe Kryeministri aktual i vendit.¹⁰⁸ Rasti në fjalë është shembujll klasik i ndikimit politik, pavarësisht faktit nëse politika ka ndërhyrë tek gjykatësja, apo nëse vetë gjykatësja ka hequr dorë nga gjykimi i rastit dhe se në të dyja rastet duhet dhënë llogari.¹⁰⁹ Pra, varësia e pushteteve e shtjelluar përgjatë këtij punimi sjellë frikë te gjykatësit, të cilët mund të dorëzohen fare pa u ndikuar. Në këtë aspekt duhet theksuar ndikimin e pavarësisë së plotë të cilën e ka gëzuar Gjykata Kushtetuese e Kosovës në ushtrimin e funksioneve të saja.

10.2. Politika e ndërhyrjeve

Politika nuk ka mbetur pa ndikuar as në procesin më të rëndësishëm të reformës në sistemin e drejtësisë, në riemërimin dhe emërimin e gjykatësve dhe prokurorëve në Kosovë, i cili ishte udhëhequr nga ndërkombëtarët përmes KPGJP-së.

Pas përfundimit të procesit të testimit dhe hetimit të të gjithë kandidatëve për gjykatës dhe prokurorë, të kryer nga ana e KPGJP-së, kjo e fundit ka rekomanduar tek KGJK kandidatët më të përshtatshëm për t'u emëruar. KGJK pas një seleksionimi kanë bërë rekomandimet përfundimtare për gjykatës dhe prokurorë tek zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës. Në tetor 2010, ish-presidenti në detyrë, Jakup Krasniqi, kishte hequr nga lista për dekretim katër gjykatës dhe prokurorë, të cilët nuk ia kishin mbushur syrin zyrtarëve të Presidencës.¹¹⁰ Katër kandidatët e përjashtuar nga lista për dekretim ishin Driton Muharremi, që njëherit ishte një nga kandidatët më të vlerësuar nga KPGJP dhe KGJK, Agron Çalaj, Florije Shamolli, dhe Vehbi Hajdini.¹¹¹ Pavarësisht kësaj, Presidenca obligohej të njoftonte KGJK-në për mos emërimin e ndonjë kandidati¹¹², këtë gjë nuk e kanë bërë zyrtarët e saj, duke lënë zyrtarisht misterioze arsyen e mosdekretimit të tyre.¹¹³ As tash kur po analizohet kjo temë në këtë raport, ende nuk dihen arsyet e mos dekretimit të tyre. Ajo që mbetet shqetësuese në rastin e këtyre katër kandidatëve, janë dosjet e tyre, të cilat janë zhdukur nga sirtarët e zyrës së Presidencës. Dosjet e këtyre kandidatëve nuk gjenden në këto zyre, përkundër faktit se drejtuesit e KGJK-së i kishin dorëzuar ato në kohën kur ishin emëruar gjykatësit dhe prokurorët në tetor të vitit 2010.¹¹⁴

Përgjegjësia kryesore për mos njoftim dhe zhdukje të dosjeve bie mbi zyrtarët e zyrës së Presidencës të Republikës së Kosovës. Megjithatë, KGJK është treguar mjaftë e ngathët të merret me këtë çështje dhe njëkohësisht është treguar e nënshtruar nga politika. Një gjë e tillë

¹⁰⁸ Me rastin e dhënies së betimit, gjykatësit dhe prokurorët betohen se do të ndajnë drejtësi bazuar në parimet universale të së drejtës dhe se para ligjit të gjithë janë të barabartë.

¹⁰⁹ Intervistë e KIPRED-it me ekspertë juridikë, korrik 2011.

¹¹⁰ Nga lista e KGJK-së e dorëzuar në Presidencë për emërimin e gjykatësve dhe prokurorëve në momentet e fundit ishin hequr katër kandidatë, përkundër rekomandimit nga ana e KGJK-së.

¹¹¹ Drejtësia në Kosovë. Projekti për Monitorimin e Gjykatave – Buletini mujor informativ. Nëntor 2010.

¹¹² Neni 2, alinea 19, Urdhëresa Administrative për Zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut numër 2006/25 mbi kornizën rregullative për sistemin e drejtësisë në Kosovë, Urdhëresë Administrative numër 2008/2.

¹¹³ "Ndikimet në sistemin gjyqësor", tetor 2010, Emisioni "Jeta në Kosovë". Shih <http://www.jetanekosove.com/shikovideo/590/Al>.

¹¹⁴ Intervistat e KIPRED-it me zyrtarët e Presidencës së Kosovës, korrik 2011.

konstatohet me mos angazhimin e anëtarëve të KGJK-së për të kërkuar përgjigjen zyrtare nga zyra e Presidencës, pavarësisht faktit se dispozita ligjore nuk e saktëson si duhet mënyrën e njoftimit nga ana e këtyre të fundit nëse duhet të bëhet me shkrim apo gojarisht. Megjithatë, në rast të mos emërimit të ndonjë kandidati sikurse ka ndodhur, zyra e Presidencës obligohet të njoftoj KGJK-në.¹¹⁵ Mungesa e përgjigjes zyrtare si dhe zhdukja e dosjeve të këtyre katër kandidatëve është bazë e mjaftueshme për hetime penale ndaj zyrtarëve përgjegjës në institucionin e Presidencës, ngase këta të fundit kanë anashkaluar mandatin dhe nuk kanë punuar konform dispozitave ligjore që rregullojnë këtë fushë.

10.3. Privilegjet politike

Një fenomen tjetër i ndërhyrjes së politikës në gjyqësor është ai i privilegjimit të zyrtarëve politikë në zbatimin e drejtësisë. Ky fenomen nuk njeh masë as kufi, meqë në shumë instanca të pushtetit gjyqësor, politikanët e posaqërisht përfaqësuesit e pushtetit ekzekutiv, janë superior. Rasti më ilustrues për këtë fenomen është sulmi në shtëpinë e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, rast i cili vazhdon të jetë temë e diskutimeve në qarqet juridike.

Ngritja e aktakuzës dhe cilësimi i veprës penale vrasje në tentativë nga ana e prokurorit është rast i pashembullt në praktikën gjyqësore.¹¹⁶ I akuzuari, z. Fazli Sejdiu, kishte hyrë në shtëpinë e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, i cili aso kohe nuk kishte qenë prezent në shtëpi. Me këtë rast kishte pasur shkëmbim zjarri ndërmjet sigurimit të shtëpisë së Kryeministrit dhe të akuzuarit, të cilët kishin marrë plagë të ndërsjella. Dëshmia e Fazli Sejdiut tregon për një tentimvjedhje në shtëpinë e Kryeministrit, ndërsa qasja e prokurorit ka shkuar deri në ngritjen zyrtare të aktakuzës për vrasje në tentativë të Kryeministrit.¹¹⁷

Praktika gjyqësore dëshmon se askund në botë nuk mund të ndodhë që dikush të sulmojë dikë në mungesë dhe të akuzohet për vrasje në tentativë, por se në këtë rast ka pasur ndikim kryekëput politika.¹¹⁸ Që nga fillimi i lëndës ka indikacione se politika në një mënyrë apo tjetër ka ndikuar në këtë proces gjyqësor.

Përkundër interesimit të gjykatësve të EULEX-it për këtë lëndë, ajo mbetet në duart e gjykatësit vendor, i cili deri më tani ka shprehur gatishmëri për të ndarë drejtësi në këtë rast, pavarësisht faktit se në këtë lëndë palë është kryeministri i vendit. Ndryshe, nga ky rast ishte vepruar në Gjykatën Komunale të Prishtinës, ku gjykatësja nuk ka pasur guxim të procedojë me lëndën e padisë ndaj Kryeministrit. Ky shembull flet për një seri të gjykatësve të cilët janë të interesuar dhe po dëshmojnë kredibilitet dhe aftësi e guxim për tu marrë me lëndë që kanë të bëjnë me profile të larta politike në Kosovë.

¹¹⁵ Neni 2, alinea 19, Urdhëresa Administrative për Zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut numër 2006/25 mbi kornizën rregullative për sistemin e drejtësisë në Kosovë, Urdhëresë Administrative numër 2008/2.

¹¹⁶ Intervistat e KIPRED-it me ekspertët juridik, korrik 2011.

¹¹⁷ Kodi Penal i Kosovës e parashih veprën penale të Vrasjes në Kapitullin 15 – Veprat penale kundër jetës dhe trupit, përkatsisht nenin 142 – Vrasja. Për të cilësuar këtë si vrasje në tentativë, kjo veprë ndërlikohet me nenin 20 – Tentativa, Kodi Penal i Kosovës. Rasti i lartëpërmendur ndërlikohet bazuar në elementet që duhet të përmbushen për kryerjen e veprës penale vrasje në tentativë.

¹¹⁸ Intervistë e KIPRED-it me ekspert juridik, korrik 2011. Si dhe intervistë e KIPRED-it me gjykatës të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, gusht 2011.

Deri më tash kur po punohet në këtë raport, ende nuk ka filluar shqyrtimi gjyqësor për këtë rast, ndërsa zyrtarët në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, kanë bërë të ditur se gjykimi pritet të mbahet në shtator 2011.¹¹⁹ Në përfundim të këtij rasti, ZPD duhet të vlerësoj veprimin e prokurorit i cili ka bërë cilësime të tilla sikurse që është vrasja në tentativë për këtë rast dhe të zbardhë burimin e kësaj anomalie.

¹¹⁹ Intervistë e KIPRED-it me Administratorin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, z. Feriz Berisha, korrik 2011.

11. PËRFUNDIMET

Ndarja e pushteteve në Republikën e Kosovës garantohet me aktin më të lartë juridik të vendit. Kushtetuta nëpër kapituj të veçantë ndan qartë rolet dhe përgjegjësitë e Legjislativit, Ekzekutivit, dhe Gjyqësorit. Ndryshe nga Kushtetuta, ligjet themelore të sistemit të drejtësisë në vend edhe pse deri në një masë kanë shtyer përpara ndarjen e pushteteve, prapë se prapë ato krijojnë varësi ndërmjet tyre. Sistemi i drejtësisë për nga rëndësia është i barabartë, por si i tillë nuk është trajtuar asnjëherë deri më tash në Kosovë. Në drejtim të lirimit të gjykatave dhe prokurorive nga lëndët e stërngarkuara si pasojë e mungesës së kushteve të punës dhe numrit të pamjaftueshëm të gjykatësve dhe prokurorëve, MD-ja është në proces të krijimit të mekanizmave jo-gjyqësorë. Këta hapa të drejtë dhe të rëndësishëm në sistemin e drejtësisë do të mundësohen përmes funksionalizimit të sistemit të noterisë, sistemit të ndërmjetësisimit dhe Gjykatës së Arbitrazhit.

Shqetësues për të ardhmen mbetet përbërja e KGJK-së, në strukturën e së cilës janë 13 anëtarë, pesë prej të cilëve emërohen nga gjyqësori dhe tetë të tjerë që vijnë nga gjyqësori dhe fusha tjera, por që emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Në mënyrën sesi aktualisht është i rregulluar mund të krijojë telashe në të ardhmen, marrë parasysh shumicën e anëtarëve që emërohen nga Kuvendi i Kosovës. Kjo ngase KGJK është institucioni i vetëm, i cili do të bëjë organizimin, seleksionimin dhe propozimin e gjykatësve, që duhet të emërohen nga Presidenti i Kosovës. Në rast se shumicën e përbëjnë përfaqësuesit që zgjedhën nga Kuvendi, mund të ngrihen dilema rreth mundësisë së ndërhyrjeve politike në këtë proces të rëndësishëm, për emërimin e përfaqësuesve që do të ndajnë drejtësi në vend.

Ndikimet si në rastin e mos emërimit të kandidatëve për gjykatës dhe prokurorë pa dhënë asnjë shpjegim ligjor nga ana e Presidentit të vendit janë të papranueshme. Ato ndikojnë në humbjen e besimit të qytetarëve për krijimin e një sistemi me emra të gjykatësve dhe prokurorëve që kanë integritet të plotë, pasi që Presidenti obligohet t'i bëjë publike ato për secilin kandidat që nuk meriton të dekretohet.

Kushtetuta me rastin e ndarjes së të drejtave e ka privuar pushtetin gjyqësor nga nismat legjislative. Primatin në hartimin e ligjeve në fushën e drejtësisë e mban MD, njëherësh përpiluese e agjendës legjislative. Problemi më i madh në këtë drejtim qëndron në konsultimet minimale me pushtetin gjyqësor sa i përket bërjes së ligjeve të cilat ndërlidhen me gjyqësorin. Si rezultat, kemi mungesë të ligjeve të cilat do të rregullonin më mirë punën e gjyqësorit dhe njëkohësisht kemi ligje pa politika dhe rrjedhimisht të pazbatueshme në praktikë. Andaj, komuniteti i juristëve që punojnë në sistemin gjyqësor dhe prokurorial do të mund të kontribuonin jashtëzakonisht shumë në plotësimin e kuadrit të nevojshëm ligjor.

Problemet e varësisë së pushtetit gjyqësor ndaj ekzekutivit, vijnë edhe si pasojë e mentalitetit të së kaluarës, sipas të cilit, ekzekutivi mban primatin për gjithçka. MD ka krijuar Këshillin Konsultativ për Drejtësi prej 18 anëtarëve, të cilët i emëron Qeveria e Kosovës. Pa miratimin e tij, respektivisht votimin e shumicës në Këshill për të dhënë mendim pozitiv për ndonjë çështje të caktuar, nuk do të mund të procedohet asgjë për rregullimin e fushës së drejtësisë. Apriori kjo tregon se ekzekutivi medoemos tenton të ketë nën kontroll çdo veprim të

gjqësorit dhe kjo është e papranueshme bazuar në parimet kushtetuese dhe aspiratat e vendit për një shtet ligjor ku pushtetet janë të ndara. Ndërhyrja e tillë nuk i lejohet ekzekutivit, megjithatë kjo nuk i justifikon drejtuesit e institucioneve të drejtësisë që të ndërmarrin hapa për krijimin e mekanizmave të vetë këshillëdhënës.

Funksionet dhe kompetencat e MD-së nuk duhet të fryhen nga ministri i saj. Ato duhet të ushtrohen në kuadër të ligjit dhe Kushtetutës. Në kundërshtim me to, në prioritetet e Ministrisë së Drejtësisë, përveç krijimit të Këshillit Konsultativ për Drejtësi, parashihen edhe një seri veprimtarish që nuk përkojnë me mandatin e kësaj ministrie. Në vazhden e prioriteteve për periudhën 2011-2014, MD merr përsipër edhe disa çështje të cilat në rend të parë janë përgjegjësi e KGJK-së dhe KPK-së, dhe ku roli i MD-së normalisht është mjaft i kufizuar. MD zotohet që të punojë në implementimin e ligjeve bazike të gjyqësorit, siç janë Ligji për Gjykatën, për Prokurorin e Shtetit, për KGJK-në, dhe për KPK-në, duke mundësuar funksionalizimin dhe strukturimin e gjykatave dhe prokurorive. Tutje, MD e sheh si përgjegjësi të veten rritjen e numrit të gjykatësve dhe prokurorëve në vend, në përputhje me nevojat dhe standardet ndërkombëtare. Bazuar në kornizën ligjore, KGJK dhe KPK janë institucionet që planifikojnë bazuar në nevojat dhe kërkesat që kanë gjykatat dhe prokuroritë për një funksion të mirëfilltë të sistemit të drejtësisë. Çdo tendencë e MD-së për t'u përzier në implementimin e këtyre ligjeve do të jetë ndërhyrje e ekzekutivit në gjyqësor, prandaj duhet të eliminohen ato parashikime dhe të kufizohet MD në kompetencat e veta.

Për pushtetin gjyqësor, përkatësisht drejtësinë në vend, vazhdimisht është ndarë më pak se 1.5 % të Buxhetit të Kosovës, përkundër shpalljes së sundimit të ligjit si njërin nga tri prioritetet kryesore të qeverisë. Kjo dëshmon në fakt anatemimin e këtij pushteti nga pushtetet e tjera. Pas Kushtetutës, hap i drejtë dhe i rëndësishëm për pavarësimin e pushteteve janë ligjet bazike si Ligji për KGJK-në dhe Ligji për KPK-në. Por, këto dy ligje propozimin e buxhetit e kanë të ndërvarur me ekzekutivin, ndryshe nga Gjykata Kushtetuese, e cila komunikon direkt me Kuvendin e Kosovës. Kjo varësi ndërinstitucionale e KGJK-së dhe KPK-së, bën që pushteti gjyqësor dhe prokurorial të mos ketë liri të plotë në menaxhimin e resurseve të veta. Për drejtuesit e institucioneve të drejtësisë kjo paraqet ndërhyrje në pushtetin e tyre dhe ndikon direkt në efikasitetin e dobët të këtij sistemi. Shembull i mirë brenda Kosovës, sesi do duhej të rregullohej mënyra e përpilimit të buxhetit për sistemin gjyqësor dhe prokurorial është Gjykata Kushtetuese, madje edhe mekanizmat brenda vetë KGJK-së, siç është Zyra e Prokurorit Disiplinor. Ndryshe, raportet e pushteteve siç janë aktualisht në Kosovë, kishin qenë të rregulluara edhe në shtetin anëtarë të BE-së, Hungarinë. Deri në vitin 2002, gjyqësori në këtë vend, buxhetin ia kishte dërguar fillimisht ekzekutivit, i cili vazhdimisht kishte treguar tendenca për të zvogëluar shumën e propozuar. Duke qenë se një qasje e tillë e ekzekutivit kishte ndikuar drejtpërdrejt në efikasitetin e gjyqësorit dhe pavarësinë e tij, më vonë është vendosur që buxheti të dërgohet drejtpërdrejt në parlament. Ky shembull do duhej të ndiqej edhe në Kosovë.

Zbatimi i pjesshëm i dy ligjeve bazike të drejtësisë atij të Gjykatave dhe Prokurorit të Shtetit, që kanë të bëjnë vetëm me ngritjen e pagave të gjykatësve dhe prokurorëve, është një hap tejet i rëndësishëm në drejtim të krijimit të barazisë së pushteteve, duke eliminuar

anatemimin e sistemit të drejtësisë. Pagat ekuivalente ndërmjet pushtetit gjyqësor dhe pushteteve tjera, janë të mirëseardhura dhe pritjet janë që ato të ndikojnë drejtpërdrejt në efikasitetin e sistemit të drejtësisë. Vetëm ngritja e pagave dhe atë vetëm për gjykatësit dhe prokurorët, nuk mjafton që të nxjerrim një përfundim se barazia ndërmjet pushteteve është arritur. Një seri privilegjesh që gëzojnë ministrat e Qeverisë së Kosovës, as për së afërmi nuk mund t'i krahasojmë me kushtet shumë të pavolitshme të punës që kanë gjykatësit dhe prokurorët. Pra, barazia e pushteteve duhet të arrihet kur gjyqësori do të gëzojë njëjtë të drejtat sikurse ekzekutivi. Buxheti i ndarë për sistemin gjyqësor dhe prokurorial nuk mund të menaxhohet në mënyrë të pavarur, pa e marrë miratimin e pushtetit ekzekutiv, kur bëhet fjalë për stafin jo-gjyqësor dhe jo-prokurorial. Punonjësit e këtyre institucioneve të drejtësisë trajtohen si staf civil, rrjedhimisht, gjithçka rreth tyre duhet të kalojë së pari për aprovim në Ministrinë e Administratës Publike. Prandaj, hap i rëndësishëm që duhet të trajtohet me urgjencë është rregullimi i statusit të punonjësve të stafit mbështetës të gjykatave dhe prokurorive, të cilëve duhet t'iu krijohen kushte të punës dhe ngritje të pagave në mënyrë ekuivalente me përgjegjësitë e tyre në punë. Rregullimi i statusit të tyre Ligjin për Shërbimin Civil do të vazhdojë të krijojë probleme, ndërhyrje dhe ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në punën e pavarur të gjykatave dhe prokurorive.

Tendencat e ekzekutivit për të mbajtur nën ombrellë Këshillin Prokurorial, kanë lënë paqartësi të mëdha në këtë ligj, në të cilin nuk parashihet zgjedhja edhe shkarkimi i drejtorit të sekretariatit të saj. Tash pas funksionalizimit të KPK-së, Prokurori i Shtetit detyrohet të zgjedh drejtorin përmes komisionit ku shumicë janë përfaqësuesit e ekzekutivit, bazuar në Ligjin mbi Shërbimin Civil. Nga ky ligj duhet të përjashtohen stafi mbështetës i gjykatave dhe prokurorive, statusi i të cilëve duhet të rregullohet përmes dy ligjeve të veçanta për administratën e gjykatave dhe prokurorive.

Çështje shqetësuese mbeten ndikimet politike në pushtetin gjyqësor dhe në proceset gjyqësore. Udhëheqësit politikë e institucionalë duhet të qëndrojnë larg proceseve gjyqësore në mënyrë që gjykatësit dhe prokurorët të ndjehen të lirë në ushtrimin e profesionit të tyre, duke nxjerrë në shesh drejtësinë. Natyrisht se kjo në asnjë mënyrë nuk i shfajëson gjykatësit apo prokurorët, të cilët ndikohen nga këto presione politike, apo edhe pa ndikime të tilla, të heqin dorë vetë nga ndarja e drejtësisë, sikurse paraqitet rasti me padinë në Gjykatën Komunale në Prishtinë, ku i pandehur është kryeministri i vendit. Është shumë vonë, madje për të vlerësuar se është koha e fundit kur qytetarët e Kosovës, presin që gjykatës dhe prokurorë vendorë t'i përmbahen dhe të veprojnë në përputhje me betimin që e kanë bërë, duke mos lejuar që askush të jetë mbi ligjin.

12. REKOMANDIMET

Pas përfundimit të hulumtimit, analizimit të gjetjeve dhe konsultimit të institucioneve e ekspertëve relevantë, instituti KIPRED nxjerrë këto rekomandime, me qëllim që të përmirësohet ndarja e pushteteve në përgjithësi dhe pavarësia e pushtetit gjyqësor në veçanti.

- 1) Përzgjedhja e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës duhet të ndryshojë ashtu që numri i anëtarëve të përzgjedhur nga Kuvendi të ulet duke lejuar që shumicën e anëtarëve t'i përzgjedhë vetë gjyqësori. Kështu, nga 13 anëtarë sa janë gjithsej, gjyqësori duhet të ketë të drejtë të përzgjedhë vetë 7 apo më shumë anëtarë. Në këtë mënyrë do të sigurojmë një gjyqësor të paanshëm dhe larg nga ndërhyrjet politike, por njëkohësisht llogaridhënës ndaj Kuvendit të Kosovës. Gjatë këtyre ndryshimeve, gjithnjë duhet të merren parasysh edhe kërkesat e Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit, që kërkon përfaqësimin e komuniteteve pakicë.
- 2) Presidenti i Republikës së Kosovës në procesin e emërimit të gjykatësve dhe prokurorëve ka rol i të kufizuar dhe nuk lejohet refuzimi për emërim pa ndonjë arsye të fortë, gjithnjë në përputhje me nenin 18 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe dispozitat e njëjta në Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Kjo do të eliminonte rastet sikurse ato që kanë ndodhur më herët e të cilat janë bërë mjaft misterioze ngase nuk është dhënë asnjë shpjegim për mos emërimin e disa prokurorëve dhe gjykatësve, madje dosjet e tyre janë zhdukur. Njëkohësisht, Presidenti duhet të vendosë çështjen e emërimit si prioritare dhe të mos ndodhë, sikurse gjatë vitit 2010, që kjo çështje ishte zvarritur me muaj të tërë.
- 3) Organet e ekzekutivit dhe sistemit gjyqësor e prokurorial duhet të ngrisin dhe zyrtarizojnë komunikimin ndërinstytucional për delegimin e përfaqësuesve të sistemit gjyqësor dhe prokurorial në grupet punuese për hartimin e legjislacionit në fushën e drejtësisë, ashtu që përfaqësuesit e gjyqësorit të shprehin mendimet e institucionit dhe jo të ndodh si në të kaluarën ku mendimet ishin individuale.
- 4) Qeveria e Kosovës duhet të anulojë vendimin për krijimin e Këshillit Konsultativ për Drejtësi, pasi që një mekanizëm i tillë paraqet ndërhyrje të ekzekutivit në sistemin gjyqësor dhe prokurorial, gjë që është në kundërshtim me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Qeveria e Kosovës dhe MD-ja duhet të heqin dorë nga krijimi i mekanizmave mbi institucionet e drejtësisë, qofshin ato vetëm këshillëdhënëse. Në anën tjetër, institucionet e drejtësisë si KGJK dhe KPK duhet të krijojnë vetë një mekanizëm të përbashkët të institucioneve të drejtësisë, me mandat këshillëdhënës, i cili do të shërbejë për identifikimin e problemeve në fushën e sundimit të ligjit dhe bashkërendimin e politikave të ndjekjes dhe gjykimit të rasteve që paraqiten.
- 5) KGJK dhe KPK duhet të bëjnë propozimin e buxhetit direkt në Kuvendin e Republikës së Kosovës, pa ndërhyrje të ndonjë organizate buxhetore. Kjo mënyrë do të siguronte shkallë më të ultë të ndikimit të ekzekutivit në ndarjen e buxhetit për

gjqësorin dhe prokuroritë, pasi që e kaluara tregon për një buxhet minimal dhe në shpërputhje me kërkesën e vetë gjyqësorit dhe prioritet e shpallura nga vetë ekzekutivi.

- 6) MD duhet të iniciojë ligjin për Administratën Gjyqësore dhe Prokuroriale, pasi që stafi jo-gjyqësor i gjykatave dhe prokurorive duhet të ndahet nga zyrtarët tjerë të shërbimit civil në Kosovë. Efikasiteti dhe profesionalizmi i gjykatave dhe prokurorive varet në masë të madhe nga stafi jo-gjyqësor dhe jo-prokurorial, që për momentin ka trajtim shumë më të keq sesa stafi civil që është në ekzekutiv. Për më tepër duhet të sigurohet pavarësi më e madhe në përzgjedhjen e stafit ku ndërhyrja e ekzekutivit duhet të evitohet, ku kërkohet që urgjentisht të ndryshohet mënyra e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm të Prokurorit të Shtetit.
- 7) Me ndryshimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, duhet të sigurohet se një anëtar i njëjtë duhet të jetë në përbërjen e të dy Këshillave. Kjo duhet të bëhet në mënyrë që të evitohen gabimet për shkak të mungesës së koordinimit ndërmjet të dy mekanizmave të drejtësisë sikurse që është rasti me propozimin e kandidatit të njëjtë për t'u emëruar prokuror dhe gjykatës njëkohësisht.
- 8) Pushteti ekzekutiv duhet të qëndrojë larg ndikimeve politike në proceset gjyqësore. Njëkohësisht, sistemi gjyqësor dhe ai prokurorial nuk duhet të lejojnë ndikime në funksionimin e sistemit të drejtësisë. Prokurorët vendorë obligohen të vihen në shërbim të zbatimit të ligjit në mënyrë të barabartë, pa dallim përfshi të gjitha profilet e larta politike.
- 9) Zyrat Ndërlidhëse të Gjykatave duhet të shuhen dhe të ngriten kapacitetet e nevojshme të gjykatave dhe degëve të gjykatave për ofrimin e shërbimeve të shpejta dhe efikase për të gjitha qendrat në Kosovë.
- 10) Shoqëria civile duhet të përqëndrohet më shumë në studimet e thella të pavarësisë së gjyqësorit dhe monitorimit të vazhdueshëm të zbatimit të kësaj pavarësie. Po ashtu, organizata të shoqërisë civile që merren me çështjet e sundimit të ligjit, duhet të komunikojnë drejtpërdrejt me KGJK dhe KPK, e jo të shërbehen vetëm me informatat që marrin nga ekzekutivi.

13. BIBLIOGRAFIA

- ABA CEELI. Analiza e Draft Ligjit në Departamentin e Administratës Gjyqësore në Republikën e Moldavisë.
- Drejtësia në Kosovë. Projekti për Monitorimin e Gjykatave – Buletini mujor informativ. Nëntor 2010.
- Freedom House. Nga Ariana Qosaj-Mustafa. Kombet në Tranzicion. 2011.
- Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Rregullore e Punës e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Rregullorja numër 185/1/2010. 2010.
- Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED). Fuqizimi i Sundimit të Ligjit në Kosovë II: Konfiskimi i pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme. Prill 2011.
Fuqizimi i Sundimit të Ligjit në Kosovë: Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Nëntor 2010.
- Këshilli i Evropës. *Sistemi Gjyqësor i Kosovës, Vlerësimi dhe Opsionet e Propozuara*. 2003-2004
- Këshilli i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial. Raporti mbi punën e Këshillit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial. Tetor 2010.
- Komisioni European. Raporti i Progresit 2010. 2010.
- Kuvendi i Kosovës. Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale.
Kodi i Përkohshëm Penal.
Kushtetuta e Republikës së Kosovës.
Ligji për Gjykatat, ligji numër 03/L-199.
Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-121.
Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, ligji numër 03/L-223.
Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, ligji numër 03/L-224.
Ligji për Prokurorin e Shtetit, ligji numër 03/L-225.
Ligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ligji numër 03/L-149.
- Ministria e Drejtësisë. Prioritetet e Ministrisë së Drejtësisë: Ministria e Drejtësisë në mandatin 2011-2014. Prill 2011.
- Ministria e Financave. Tabelat e Buxhetit për vitin 2011.
- Organizata e Kombeve të Bashkuara. Principet bazike për Pavarësinë e Gjyqësorit. 1985.
- Parlamenti i Kroacisë. Komiteti Kombëtar. Arritja e objektivave në kaptinën 23 – Gjyqësori. Ligji mbi Këshillin Kombëtar Gjyqësor, ligji numër 3051.

Qeveria e Republikës së Kosovës. Rregullore për fushat e përgjegjësive administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive, rregullorja numër 02/2011. 2011.
Vendimi për themelimin e Këshillit Konsultativ për Drejtësi, Vendimi nr. 04/13. Prill 2011.

Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Statistika e gjykatave të rregullta, raporti tre mujor 2011. 2011.

UNDP. Faktet e Shpejta. 2009.
Raporti i Paralajmërimit të Hershëm. Maj-gusht 2002.

UNMIK. Rregullore për Themelimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, rregullore numër 2005/52.
Urdhëresa Administrative për Zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut numër 2006/25 mbi kornizën rregullative për sistemin e drejtësisë në Kosovë, Urdhëresë Administrative numër 2008/2.

Zyra e Kryeministrit të Kosovës. Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2008-2011. Prill 2008.
Strategjia Legjislative për vitin 2011. 2011.